



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I DREJTËSISË
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
FACULTY OF LAW

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

Krahasimi mes sanksioneve kundërvajtëse dhe atyre penale
– me theks të veçant gjobës dhe dënimit në të holla, në
Republikën e Maqedonisë së Veriut nga viti 2006

Kandidatja:

Kaltrina Limani Zeqiri

Mentor:

Prof.Dr.Ismail Zejneli

Tetovë, Shkurt 2021

Deklaratë

Unë Kaltrina Limani deklaroj me përgjegjësinë më të lartë juridike e morale se jam autore e këtij punimi të masterit, që është tërsisht origjinal dhe nuk përmban asnjë pjesë nga puna e personave të tjerë pa u cituar. Bibliografia e poshtë shënuar përmban të gjithë literaturën që kam shfletuar dhe konsultuar në shkrimin e këtij punimi, dhe të gjitha citimet i referohen kësaj bibliografie. Jam e vetëdëshme se çdo shkelje e këtyre rregullave do të konsiderohet mashtrim dhe për këtë vijojnë pasojat juridike.

Falënderim

Fillimisht dua të shpreh falënderimet më të thella dhe më të sinqerta për të gjithë stafin akademik të fakultetit juridik pranë Universitetit të Evropës Juglindore, për kontributin dhe mbështetjen e dhënë në rrugëtimin tim akademik si studente në studimet pasdiplomike, poashtu edhe në ato deridiplomike. Dhe tani dëshiroj të veçojë dhe ti shpreh një falënderim të veçantë mentorit tim Prof.Dr. Ismail Zejneli për udhëzimet, këshillimet, rekomandimet, komentet dhe drejtimin që më ka dhënë nga përzgjedhja e deri në përfundimin e kësaj teze.

Falemenderoj përzemërsisht familjen time që më ka mbështetur dhe më ka përkrahur gjatë gjithë rrugëtimin tim, posaçërisht prindërit e mi nga të cilët kam marrë ligjëratat dhe këshillat më të rëndësishme e më të vlefshme të jetës. Dhe si në fund, falënderimet e mia më të sinqerta shkojnë për bashkëshortin tim, i cili më ka motivuar dhe ndihmuar në çdo aspekt.

Dedikuar birit tim, MAL ZEQRIRI.

Abstrakt

Në këtë punim të magistraturës në fillim do të trajtohen njohuri të përgjithshme mbi sanksionet kundërvajtëse në përgjithësi dhe për të gjitha sanksionet tjera kundërvajtëse, e në veçanti do të trajtohet gjoba - si sanksion kryesor në të drejtën kundërvajtëse, duke u bazuar në ligjin për kundërvajtje të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu do të trajtohen sanksionet penale në përgjithësi, e në veçanti dënimin në të holla (gjoba) si sanksion penal, i cili shqiptohet në gjobë ditore, duke u bazuar në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Poashtu përpos analizimit dhe krahasimit të këtyre sanksioneve, do të elaborohen edhe anketat e realizuar, me qëllim për të nxjerrur një hulumtim sa më kualitativ, rëndësia e të cilit qëndronë në rrezulltatet e arritura dhe ofrimin e informacionit sa më adekuat lidhur me lëndën e hulumtimit.

Unë besoj se puna ime do të jep një kontribut të rëndësishëm shkencor drejt reformimit të legjislacionit për kundërvajtje që trajton sanksionet kundërvajtëse - gjobën, që të arrihet ekuivalenca për matjen e sanksioneve në mes sanksionit kundërvajtës - gjoba dhe sanksionit penal - dënimit në të holla (gjoba ditore). Si çdo punim tjetër i kësaj kategorie edhe ky punim ka rëndësinë e vetë, qëllimi i të cilit është ngritja e nivelit në shoqëri, nga se i gjithë hulumtimi bëhet për tu informuar, dhe për ti ofruar shoqërisë dhe insitucionve shtetërore njohuri dhe informacion orientues mbi rëndësinë dhe vlerën e gjobës dhe dënimit në të holla, e njëkohësisht duke bërë krahasimin në mes tyre.

***Fjalët Kyçe:** Sanksionet kundërvajtëse, Sanksionet penal, Dënimi në të holla, Gjoba, Harmonizimi i legjislacioneve.*

Tabela e Përmbajtjes

Deklaratë.....	2
Falënderim.....	3
Abstrakt	4
Tabela e Përmbajtjes	5
Tabela e Grafikonëve.....	7
Hyrje.....	8
Metodat e hulumtimit	10
Kapitulli i I.....	11
1. Sanksionet kundërvajtëse në përgjithësi, nocioni, zhvillimi historik dhe llojet	11
1.1. Sanksionet kundërvajtëse sipas ligjit për kundërvajtje	12
1.1.1. Sanksionet kundërvajtëse për kryersit e moshës madhore	16
1.1.2. Sanksionet kundërvajtëse për fëmijë.....	20
1.1.3. Sanksione për kundërvajtje për persona Juridikë dhe tregtar individ ..	20
1.1.4. Masat e posaçme të kundërvajtjes.....	20
1.2. Gjoha, nocioni dhe zhvillimi historik i saj.....	21
1.3. Gjoha si sanksion primar kundërvajtës sipas ligjit për kundërvajtje	22
1.4. Gjoha si sanksion kundërvajtës dhe procedurat për shqiptimin e këtij sanksioni sipas ligjeve tjera materiale, si psh: Ligji për Dogana, Ligji për Siguri në Komunikacionin Rrugor dhe Ligji për Pyjet.....	23
1.4.1. Ligji për dogana	23
1.4.2. Ligji për siguri në komunikacionin rrugor	24
1.4.3. Ligji për pyjet	28
1.5. Shqiptimi dhe matja ligjore e gjobës	29
sipas ligjit për kundërvajtje.....	29
1.5.1. Afati për pagesën e gjobës	30
1.5.2. Realizimi i gjobës dhe lirimi nga sanksioni.....	30
1.5.3. Baza e posaçme për lirim nga sanksioni.....	31
2. Sanksionet penale ne përgjithësi, nocioni, zhvillimi historik dhe llojet	32
2.1. Nocioni	32
2.2. Zhvillimi historik	33
2.3. Llojet e sanksioneve penale.....	34

2.4. Sanksionet penale sipas Kodit penal të RM-së	34
2.4.1. Dënimet	35
2.4.2. Masat altrenative.....	37
2.4.3. Masat siguruese	38
2.4.4. Masat edukuese	39
2.5. Dënimi në të holla (me gjobë)	40
2.5.1. Zhvillimi i dënimit me të holla në sistemin e sanksioneve	41
2.5.2. Nocioni i dënimit me të holla (gjobë).....	42
2.5.3. Sistemi i gjobës ditore	44
2.5.4. Regjimi ligjor i dënimit me gjobë, shqiptim dhe matja ligjore e gjobës ditore	44
2.5.5. Arkëtimi dhe ndërrimi i gjobës ditore (Pagesa dhe zëvendësimi i dënimit me gjobë).....	47
Kapitulli i III	48
3. Aspektet krahasimore të gjobës si sanksion kundërvajtës dhe gjobës si sanksion penal.....	48
3.1. Ngjajshmëria si masë shtërnguse e tyre dhe mënyra e normimit të sanksionit	48
3.2. Dallimet në mes organeve që shqiptojnë, procedura deri te shqiptimi, si dhe pesha e sanksionit	49
3.2.1. Procedura kundërvajtëse para organeve për kundervajtje	51
3.2.2. Procedura kundërvajtëse para gjykatës.....	53
Kapitulli i IV.....	57
4. Pyetsori dhe rezultatet e fituara nga anketat dhe intervistat e përpiluara.....	57
4.1. Të dhënat nga anketa e ralizuar me personat të cilët posedonjë njohuri profesionale në lidhje me këtë tematikë (Grupi i Juristëve):	58
4.2. Të dhënat nga anketa e ralizuar me qytetarë të cilët nuk kanë njohuri profesionale në lidhje me këtë tematik (Grupi laik):	65
4.3. Vendimet gjyqësore kundërvajtëse	70
Përfundim	85
Bibliografia	87
Shtojcë.....	89

Tabela e Grafikoneve

Grafikoni 1 - A mendoni se gjobat e parapara sipas ligjit për kundërvajte dhe ligjeve tjera materiale, janë në përputhje me standardet ekonomike të RMV-së?	58
Grafikoni 2 - Dënimi në të holla (gjoba) i shqiptuar si sanksion penal, a e tejkalon peshën e veprës së inkriminuar?	59
Grafikoni 3 - Gjobat e shqiptuara si sanksion kundërvajtës, a e tejkalojn peshën e veprës së inkriminuar?	59
Grafikoni 4 - Sipas përvojës që ju keni me palë, a mendoni se të njejtit kanë njohuri për dallimet procedurale të gjobës (si sanksion kundërvajtës) dhe dënimit në të holla (si sanksion penal)?.....	60
Grafikoni 5 - Nga përvoja juaj, përveç gjobës si sanksion kundërvajtës, a ka raste ku krahas saj shqiptohen edhe sanksione tjera kundërvajtëse?	61
Grafikoni 6 - A posedohen mehanizma të mjaftueshme për zbatimin e sanksionit me gjobë?.....	61
Grafikoni 7 - A mendoni se sanksionet kundërvajtëse (gjobat) duhet të jenë më të ulta?	62
Grafikoni 8 - A mendoni se ka nevoj për ndryshime ligjore sa i perket normimit të veprave kundërvajtëse?.....	62
Grafikoni 9 - A keni patur rastin të shqiptoni gjoba kundërvajtëse nga lëmija e mbrojtjes së konkurrencës?	63
Grafikoni 10 - A keni marur pjesë ndonjëherë në procedurë kundërvajtëse ose penale?.....	65
Grafikoni 11 - A keni qenë ndonjëherë i dënuar me dënim me gjobë?.....	65
Grafikoni 12 - A keni njohuri se ekzistojn gjoba kundërvjtëse me shumë mbi 5000 Euro?	66
Grafikoni 13 - A janë të larta gjobat kundërvajtëse, sipas standardit ekonomik në RMV?	66
Grafikoni 14 - A dini se përvecse ligjit për kundërvajtje sanksionet kundërvajtëse janë të parapara edhe në ligjet tjera?	67
Grafikoni 15 - A keni ndëgjuar se dikujt apo juve i ëshë shqiptuar krahas gjobës kundërvajtëse edhe sanksion tjetër kundërvajtës (masa siguruse)?.....	67
Grafikoni 16 - A ndodh shpesh që në shoqërinë tuaj të diskutoni rreth gjobave dhe problemeve gjyqësore?	68
Grafikoni 17 - Si mendoni a ka më shumë dënime me gjobë (si sanksion kundërvajtës) apo dënime në të holla (si sanksion penal) në RMV-së?	68

Hyrje

Objekt apo lëndë e hulumtimit në këtë tezë masterit do të jenë sanksionet kundërvajtëse në përgjithësi, duke sqaruar çka është sanksioni kundërvajtës, për të gjitha sanksionet tjera kundërvajtëse, e në veçanti do të ndalem të flas për gjobën - si sanksion kryesor në të drejtën kundërvajtëse, duke u bazuar në ligjin për kundërvajtje të Republikës së Maqedonisë së Veriut. E poashtu do të hulumtohen sanksionet penale në përgjithësi duke sqaruar çka është sanksioni penal, për të gjitha sanksionet tjera penale e në veçanti do të flas për dënimin në të holla, i cili shqiptohet në gjobë ditore, duke u bazuar në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi kryesor pse jam qasur këtij hulumtimi është se në të drejtën penale, nocioni i sanksionit përcaktohet si pasojë juridike e veprës së inkriminuar, dhe se gjatë shqiptimit të sanksionit gjithmonë duhet pasur parasysh që sanksioni si masë ndëshkuese të jetë i drejtë dhe proporcional me peshën e veprës së inkriminuar dhe gjithmonë duke e matur e duke e krahasuar me të mirat që i kufizohen apo që i meren personit për kryerjen e veprës së ndaluar. Duke pasur në konsiderat këtë përkufizim për sanksionin nga autorë të ndryshëm, mendoj se sanksionet kundërvajtëse, posaçërisht gjoba kohëve të fundit largohet nga ky përkufizim dhe pikërisht për këtë arsye do ti qasem këtij hulumtimi, duke elaboruar edhe raste konkrete si aktgjykime penale dhe aktgjykime kundërvajtse në lëmi të shprehura si në sferën e doganave poashtu edhe në sferën nga mbrotja e pozitës monopolistike.

Hipotez kryesore e kësaj teze është ajo se duke krahasuar sanksionin e njohur të së drejtës penale “gjobën” i cili historikisht ka evluar, del në pah se njihet shumë më parë se sanksionet tjera penale të së drejtës bashkëkohore, e veçanërisht në të drejtën kundërvajtëse është edhe sanksioni kryesor dhe më i rëndësishëm.

Krahasimi në mes sanksioneve kundërvajtëse dhe atyre penale mund të ndihmoj në ardhjen e sanksioneve më të drejta dhe të sakta, mundësohet të vërehet mospërputhja e gjobave dhe dënimeve në të holla me lartësinë mesatare të pagës në RMV-së, poashtu mund të ndihmoj që në të ardhmen gjoba dhe dënimi në të holla të jenë në nivelin e duhur, dhe tju përshshtaten standardeve të RMV-së.

Duke analizuar, krahasur, anketuar dhe intervistuar dhe duke i permbledhur të gjitha këto së bashku për të nxjerë një hulumtim sa më kualitativ, rëndësia e të cilit qëndron në

rezultatet e arritura dhe ofrimin e informacionit sa më adekuat lidhur me lëndën dhe qëllimin e tezës.

Njëkohsisht përmes këti punimi theksohet edhe rëndësia e bashkpunimit të patjetërsueshëm mes shumë institucionve dhe shkëmibimin e informacioneve për të pasur pasqyrim sa më real të problemeve dhe pamundësive që sanksioni si masë ndëshkuese të jetë i drejtë dhe proporcional me peshën e veprës së ikriminuar dhe gjithmonë duke e matur e duke e krahasuar me të mirat që i kufizohen apo që i miren personit që ka kryer veprën e ndaluar, e që është e parapar me ligj.

Si çdo punim tjetër i kësaj kategorie edhe ky punim ka rëndësinë e vet edhe atë që të ngrit nivelin në shoqëri, sepse i gjithë hulumtimi bëhet për tu informuar, dhe për ti ofruar shoqërisë dhe insitucionve shtetëore njohuri dhe informacion orientues mbi rëndësinë dhe vlerën e gjobës dhe dënimit në të holla, e njëkohësisht duke bërë krahasimin në mes tyre.

Metodat e hulumtimit

Për hulumtimin, kërkimin dhe studimin e rasteve lidhur me këtë punim do të shfrytëzohen këto metoda:

Metoda analitike - Kjo metodë do të zbatohet në lidhje me analizimin e gjendjes aktuale, programeve që zbatohen si dhe formave të bashkëpunimit mes institucioneve.

Metoda Deduktive - Kemi të bëjmë me veprime nga e përgjithshmja kah konkretja dhe e veçanta. Deduksioni gjithmonë supozon njohjen e qëndrimeve të përgjithshme, të parimeve, posedimin e njohurive të përgjithshme, në bazë të të cilave kuptohet ajo që është e veçantë, njohuri të veçanta.

Metoda krahasuese - Kjo metodë do të shërbej për të krahasuar periudhat kohore, legjislatcionet e ndryshme si dhe për krahasimin mes organeve dhe metodave që i aplikojnë ato legjislatcione.

Metoda Historike - "Ta njohim të kaluarën për ta kuptuar të tashmen", metoda historike lidhet drejtpërsëdrejti me historinë e së drejtës, ku që nga ajo kohë janë hasur legjislatcione të ndryshme, që në disa raste kanë qenë më përparimtare shikuar nga aspekti i tanishëm.

Metoda Dogmatike Pozitiviste - Për dallim nga metoda Historike, metoda pozitive nuk meret me të kaluarën, por asaj i intersojn aktualja që në juridik njihet si pozitive dhe mbështet në mendimin se normat juridike duhet të jenë dogmatike pra të jenë në hap me periudhën aktuale dhe të njejtat të zbatohen ashtu siç janë të shkruara.

Metoda e njohjes – Do shikohet se si ndikohet nga faktorë të jashtëm apo realiteti objektiv. Pra e vërteta objektive është e lidhur gjithnjë me një realitet objektiv;

Metoda e Anketimit – Është metodë që zbatohet drejtpërsëdrejti me qytetarët, ku nëpërmjet pyetësorëve të shkruar tentohet që të meren ide, informacione, mendime nga qytetarët për çështje të caktuara. Kjo metodë do të zbatohet drejtpërsëdrejti me jurist, student dhe personat zyrtarë të disa institucioneve, sic janë: gjykatës, prokurorë, avokatë, ekspert juridik, etj

Kapitulli i I

1. Sanksionet kundërvajtëse në përgjithësi, nocioni, zhvillimi historik dhe llojet

Lëndë e së drejtës kundërvajtëse janë kundërvajtjet të parashikuara me ligjin për kundërvajtje dhe ligje tjera.¹ Për kundërvajtje të caktuara me ligj sanksion mund të shqiptoj organi i administratës shtetërore ose organizata dhe organi tjetër që ushtron autorizime publike.² Sanksionet kundërvajtëse janë mjete juridike “represive,, me të cilat realizohet funksioni mbrojtës i së drejtës, poashtu ato janë masa dhune të përcaktuara në ligjin për kundërvajtje, të cilat i shqipton gjykata për kundërvajtje ose organi tjetër kundërvajtës në procedurë ligjore, kryersve të veprave kundërvajtëse, të cilat shqiptohen dhe aplikohen kundër vullnetit të kryesit dhe konsistojnë në marrjen apo kufizimin e disa të drejtave të cilat i kanë gëzuar gjerë në momentin e kryerjes së veprës kundërvajtëse me qëllim të mbrojtjes së rendit dhe qetësisë publike, rendit dhe disiplinës së përgjithshme shoqërore duke mbrojtur, te mirat juridike që i përkasin shoqërisë dhe individit, qëllimi i së cilës është luftimi i sjelljeve anti sociale, gjegjësisht sjelljeve dhe veprimeve të cilat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të cilat bartin edhe dënime të caktuara, që në këte rast na paraqiten si dënime kundërvajtëse.

Sanksionet kundërvajtëse poashtu paraqesin pjesën më dinamike të së drejtës, si dhe sfidën dhe përballjen më të shpeshtë institucionale me subjektet e së drejtës, me qëllim zbatimin e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të sanksioneve kundërvajtëse.

Historiku i zhvillimit të sanksioneve kundërvajtëse dhe ndëshkimore, paraqet vet historikun e së drejtës kundërvajtëse në lëmin penal. Kur thuhet kjo meret parasysh fakti se gjatë gjithë historikut të zhvillimit të shoqërisë njerëzore kemi patur sjellje, veprime të ndaluar dhe të dëmshme të individit- individëve, e ndaj të cilëve shoqëria me masa të caktuara represive, e ka luftuar këtë sjellje të dëmshme dhe të ndaluar. Mirëpo sanksionet kundërvajtëse më tepër janë të drejtuara kah e ardhmja, e më pak kah e kaluara.³

¹ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli: E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.28

² Po aty, fq.28

³ Bajram Ukaj: Kundërvajtjet në lëmin Penal - Leksione të autorizuara (Dispencë), Prishtinë, 2010,

Sanksionet kundërvajtëse duhet kuptuar si mjete juridike të cilat i ndërmarrin organet kompetente shtetërore për të mbrojtur individin dhe shoqërinë nga veprimet e kundërligjshme në përgjithësi dhe nga veprat kundërvajtëse në veçanti. Ose ndryshe thënë janë masa represive, të cilat u shqiptohen kryesve të veprave kundërvajtëse, ndërsa në kuptimin më të gjërë juridik ato paraqesin mjete ndëshkimore juridike-kundërvajtëse, të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore, të cilat i shqipton gjykata ose organi kundërvajtës me anë të zhvillimit të procedurës kundërvajtëse, duke i dhënë epilog përfundimtarë me anë të aktëvendimit apo aktëgjykimit ndaj kryesve të veprave kundërvajtëse me qëllim të:

- Mbrojtjes së rendit dhe qetësisë publike në shoqëri, disiplinës së përgjithshme shoqërore, e që kanë për efekt kufizimin ose heqjen e lirive dhe të drejtave të caktuara;
- Paralajmrimin e mundësisë së heqje ose kufizim të tyre, ose evitimin e gjendjeve dhe kushteve të cilat mund të ndikojnë që kryesi në të ardhmen të kryej vepër kundërvajtëse;
- Në dhënien e mbrojtjes ose ndihmës së kryerësve të mitur të veprave kundërvajtëse duke i aftësuar ata profesionalisht dhe duke e zhvilluar përgjegjësinë e tyre personale-individuale, duke siguruar edukim, riedukim dhe zhvillim të drejtë të tyre dhe duke ushtuar ndikim të shtuar ndaj tyre, që në të ardhmen mos të kryejnë vepra kundërvajtëse;
- Të përmbahen persona të tjerë nga kryerja e veprave kundërvajtëse;⁴

1.1. Sanksionet kundërvajtëse sipas ligjit për kundërvajtje

Si parim bazë i së drejtës nga ku edhe veprimet e caktuara klasifikohen si vepra të dënueshme, qofshin ato vepra penale apo kundërvajtëse na paraqitet parimi i njohur juridik „parimi i legaliteti” ku në lëminë e së drejtës zanafilla e këti parimi paraqitet që nga e drejta Romake me termin Latin “Nullum Crimen, Nulla Poena sine lege” që ne gjuhën shqipe do të thotë “Nuk ka krim, nuk ka ndëshkim nëse nuk ka ligj”, ku dhe organet shtetërore detyrohen që dispozitat ligjore dhe veprimtarinë e tyre ta regullojnë saktë dhe në mënyrë decide të përcaktojnë veprimet të cilat paraqesin vepër kundërvajtëse sipas këti parimi. Ky parim në aspektin juridik interpretohet drejtpërsëdrejti me anë të normave ligjore, dhe si shembull të drejtpërdrejtë kemi nenin 3 të Ligjit për Kundërvajtje të RMV i vitit 2006, i cili thotë: “Askujt nuk mund t’i shqiptohet sanksioni i kundërvajtjes, për kundërvajtjen e cila para

⁴ Bajram Ukaj: Kundërvajtjet në lëmin Penal - Leksione të autorizuara, Prishtinë, 2010,

se të kryhet nuk ka qenë me ligj e përcaktuar si kundërvajtje dhe për të cilën me ligj nuk është përcaktuar sanksion”.

Për të kuptuar më qartë të drejtën kundërvajtëse në kuptim më të gjërë dhe për ta ndërlidhur atë drejtpërsëdrejti me normat ligjore duhet të përmenden dhe shqyrtohen elementet themelore të veprës kundërvajtëse, të cilat në rënditje taksative na paraqiten si një bashkësi, ku në mungesë të njërit nga elementet do të ishte thujse e pamundur klasifikimi i veprimit si vepër kundërvajtëse dhe ndaj të njejtit veprim nuk do të mund të shqiptohet sanksion.

Si elemente kryesore të veprës kundërvajtëse janë:

- Veprimi/mosveprimi i njeriut me pasojën e shkaktuar - vepra kundërvajtëse kryhet me veprim dhe me mosveprim. Veprat të cilat kryhen me veprim do të thotë se njeriu ka ndërmarë akt ose për kryerjen e veprës dhe njihet si “Delicta Comisiva”, ndërsa veprat kundërvajtëse që kryhen me mosveprim nënkupton atë që njeriu ka qenë i obliguar të ndërmarr një veprim dhe nuk e ka ndërmarë të njejtin, në atë rast ka kryer vepër kundërvajtëse me mosveprimin e tij, që ndryshe njihet si “Delicta omisiva”.⁵

- Përcaktueshmëria e veprës kundërvajtëse - nuk ka vepër kundërvajtëse nëse ajo para se të jetë kryer nuk është përcaktuar si vepër kundërvajtëse dhe për të cilën nuk është paraparë vepër kundërvajtëse.

- Kundërligjshmëria e veprës kundërvajtëse - për të ekzistuar vepër kundërvajtëse ajo duhet të jetë e drejtuar në shkeljen e dispozitave ligjore.

- Rezikshmëria shoqërore - për të ekzistuar vepra kundërvajtëse ajo duhet të jetë e rezikshme për shoqërinë dhe të çënoj të mirën e mbrojtur me ligj.

- Fajësia - fajësia paraqet elementin subjektiv të veprës kundërvajtëse që lidhet drejtpërsëdrejti me kryerësin dhe përgjegjësitë që i bartë kryerësi i veprës kundërvajtëse.

Të gjitha elementet e lartpërmendura i hasim të ndërthurura në pjesën e përgjithshme të ligjit për kundërvajtje të RMV-së, e cila i përcakton edhe karakteristikat dhe definimin e veprës kundërvajtëse duke u konkretizuar në nenin 5 të këtij ligji, që e definon veprën kundërvajtëse si në vijim: “Kundërvajtja është vepër e kundërligjshme e cila me ligj është

⁵ Botim elektronik “Nocioni dhe karakteristikat themelore të së drejtës penale”
<https://juristat.files.wordpress.com> faqe 23.

përaktuar si kundërvajtje, karakteristikat e së cilës janë përcaktuar me ligj dhe për të cilën janë përcaktuar sanksione kundërvajtëse”.

Për sa i përket elementit të **veprimit** atë e gjejmë qoftë në ligjin për kundërvajtje si referencë kryesore, qoftë në ligje tjera materiale të cilat kanë paraparë vepra kundërvajtëse në fushëveprimin të cilin ato e rregullojnë. Ligji për kundërvajtje i RMV-së në nenin 6, pika 2 dhe pika 3 parasheh :

Pika 2. Personit përgjegjës tek personi juridik ose tregtarit individualë do ti shqiptohet sanksion kundërvajtës për kundërvajtje deri tek e cila ka ardhur me veprimin e ti, leshim veprimi dhe leshimimin e mos kryerjes së mbikqyrjes së detyruar.

Pika 3. Personi juridik është përgjegjës për kundërvajtje nëse në kryerjen e kundërvajtjes ka ardhur me veprim, leshim të veprimit apo me leshimin e mbikqyrjes së detyrueshme nga organi kompetent apo personi përgjegjës në personin juridik apo me veprimin apo leshimin e personit tjetër që ka qenë i autorizuar të veprojë në emër të personit juridik, në kuadër të mbikqyrjes së tij, apo kur i njëjti i ka tejkalar autorizimet e tij për realizim të dobisë materiale për personin juridik.

Elementin e **përcaktueshmërisë me ligj** që ndryshe njihet edhe elementi ose parimi i legaliteteti, lidhet me pjesën e mësipërme ku thamë se askujt nuk mund ti shqiptohet sanksion kundërvajtës për vepër e cila paraprakisht nuk ka qenë e paraparë si e tillë duke u pamundësuar në këtë formë keqpërdorimin dhe keqinterpretimin e veprave, ndërsa të njëjtin parim e kemi të paraparë edhe si normë kushtetuese ku me anë të nenit 14 të Kushtetutës së vendit tonë thuhet se “Askujt nuk mund ti shqiptohet dënim për vepër e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e vërtetuar me ligj ose akt tjetër si vepër e dënueshme dhe për të cilën nuk ka qenë i paraparë dënim”. Të dënohet përsëri për vepër që tashmë ka qenë i dënuar dhe për të cilën është sjellë aktvendim i plotëfuqishëm është e pamundur dhe i njëjti parim në mënyrë automatike lidhet me parimin e ardhshëm që njihet si parimi i kundërligjshmërisë.

Kundërligjshmëria është element i përgjithshëm i çdo vepre penale. Disa shkencëtar të së drejtës penale bëjnë dallimin e nocionit të kundërligjshmërisë në: kuptimin formal dhe kuptimin material.⁶

⁶ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli: E drejta Penale – pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.23

1. Kundërligjshmëria në kuptimin formal - është veprim që paraqitet si shkelje e ndonjë norme, e ndonjë urdhrese apo ndalese, e cila me ligj është përcaktuar si veprë penale ose kundërvajtëse.

2. Kundërligjshmëria në kuptimin material - nënkupton ato sjellje të njeriut të cilat janë në kundërshtim me normën e caktuar juridike, e cila në të njëjtën kohë e dëmton apo rrezikon të mirën juridike që është e mbrojtur me atë normë.

Rrezikshmëria shoqërore mund të konsiderohet si element i cili tërheqë vijnë ndarëse ose ndryshe përcakton kufinj të se kur ligji një veprim e konsideron si veprë kundërvajtëse e kur si veprë penale, pikërisht me anë të shkakimit të rrezikshmërisë shoqërore. Andaj veprat të cilat kanë më pak të theksuar këtë element ligji i ka veçuar nga veprat penale dhe i ka parapare ne grupin e veprave kundërvajtëse. Si vepra të rrezikshme konsiderohen ato veprime apo sjellje të cilat dëmtojnë apo rrezikojnë vlerat themelore siç janë: të drejtat themelore dhe liritë e njeriut, pasuria, barazia dhe siguria e tyre juridike, rregullimi juridik i përcaktuar me kushtetutë.⁷

Tek pjesa e rregullave të përgjithshme për zbatimin e sanksionit neni 26 i ligjit për kundërvajtje të RMV-së parasheh: Kryerësit të kundërvajtjes i përcaktohet sanksionin, kufijtë e të cilit janë përcaktuar me ligj për kundërvajtjen, duke e pasur parasysh përgjegjësinë e kundërvajtjes së kryerësit dhe peshën e kundërvajtjes për veprën e kryer. Gjatë përcaktimit të sanksionit merren parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë, që sanksioni të jetë më i lehtë apo më i rëndë (rrethana lehtësuese dhe rënduese), e veçanërisht shkalla e përgjegjësisë së kryerësit për kundërvajtjen, motivet nga të cilat është kryer kundërvajtja, fuqia e rrezikimit apo shkeljes së të mirës së mbrojtur, rrethanat me të cilat kundërvajtja është kryer, jeta e mëhershme e kryerësit, rastet e tij personale dhe sjellja e tij pas kundërvajtjes, veçanërisht nëse e ka kompensuar dëmin, si dhe rrethanat tjera që i referohen personalitetit të kryerësit.⁸

Elementin e **fajsisë** e gjejmë të inkorporuar në dispozitat ligjore kundërvajtëse edhe atë duke përfshirë dhe radhitur subjektet juridike, ndaj të cilëve mund të shqiptohet sanksion në qoftë se të njëjtit bartin faj. Në neni 4 të ligjit për kundërvajtje të RMV-së parashihet se për kundërvajtjen e kryer me kushtet e këtij ligji, shqiptohen këto lloj sanksionesh: 1) sanksionet e

⁷ Ela PODGORICA (KERKA): Refleksione mbi anën objektive të figurës së veprës penale - Punim shkencorë

⁸ Neni 26: Ligji për kundërvajtje, 12.05.2006 – Republika e Maqedonisë

kundërvajtjes për kryerësit e moshës madhore, 2) sanksionet e kundërvajtjes për fëmijë, 3) sanksionet e kundërvajtjes për persona juridikë dhe 4) masat e posaçme të kundërvajtjes.

1.1.1. Sanskionet kundërvajtëse për kryerësit e moshës madhore

Në kundërvajtje më të shpeshta dhe më të përsëritura janë sanksionet e grupmoshave të mëdha, ligji në këtë rast është shumë decid, ku në nenin 13 të Ligjit për kundërvajtje të RMV-së thotë se për kundërvajtjet e kryerësve të moshës madhore të cilët janë përgjegjës për kundërvajtje, mund t'u shqiptohen sanksionet në vijim, si:

- 1) vërejtje;
- 2) gjobë;
- 3) shfuqizim i patentë shoferit;
- 4) ndalim i drejtimit të automjetit;
- 5) ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- 6) dëbimi i të huajit nga vendi;
- 7) mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve (personave me sëmundje të varësisë);
- 8) mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri, dhe
- 9) ndalimi për hyrje dhe pjesëmarrje në ndeshje sportive.⁹

Vërejtja

Vërejtja i përket grupit të sanksioneve të lehta dhe shqiptohet në vend të gjobës kur bëhet fjalë për kundërvajtje të lehta.¹⁰ Vërejtje mund të shqiptohet edhe nëse kundërvajtja përbëhet nga mosplotësimi i obligimit të përcaktuar apo me kundërvajtje është shkaktuar dëmi, e kryerësinë rast para miratimit të vendimit për kundërvajtje e ka plotësuar obligimin e përcaktuar, përkatësisht e ka mënjanuar apo e ka kompensuar dëmin e shkaktuar.¹¹

⁹ Neni 13: Ligji për kundërvajtje, 12.05.2006 – Republika e Maqedonisë

¹⁰ Neni 14: Po aty,

¹¹ Neni 18: Po aty,

Gjoba

Në kundërvajtjet gjoba përcaktohet dhe shqiptohet si sanksion kryesor. Gjoba për personin fizik përbëhet nga pagesa e shumës së përcaktuar me para që nuk mund të jetë më e vogël se 15 euro në kundërvlerë me denarë, e as më e madhe se 1 000 euro në kundërvlerë me denarë, ndërsa për personin përgjegjës në personin juridik dhe tregtarin individ është 30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik respektivisht tregtarin individ. Sa i përket personit zyrtar nuk mund të jetë më e vogël se 50 euro në kundërvlerë me denarë, e as më e madhe se 2 000 euro në kundërvlerë me denarë. Mirëpo në vetë ligjin për kundërvajtje mund të përcaktohen shuma më të larta nga ato të lartpërmëna.¹²

Në vendimin për kundërvajtje përcaktohet afati për pagesën e gjobës që nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë ditë e as më i gjatë se 30 ditë nga dita e vendimit të plotfuqishëm, përkatësisht vendimit përfundimtar. Në rastet e caktuara kur kryerësi nuk ka pronë të mjaftueshme, nuk është i punësuar, është i sëmurë nga ndonjë sëmundje dhe rrethana tjera të ngjashme që e arsyetojnë këtë, mund të lejohet që gjoba të paguhet në këste. Në këtë rast, do të caktohet mënyra e pagesës dhe afati i pagesës që nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj.¹³ E nëse ndodh që kryerësi pjesërisht apo plotësisht nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë tatimore të RMV-së.¹⁴

Shfuqizimi i patentë shoferit

Gjykata do të shqiptojë shfuqizim të patentë shoferit, nëse është kryer kundërvajtje në sferën e komunikacionit rrugor me të cilën shkaktohet rrezik për ndodhjen e pasojës së rëndë apo nëse është parashtruar dëshmi se kryerësi ka arritur 100 pikë negative në komunikacionin rrugor në tri vitet e fundit, këto pikë negative përcaktohen me Ligjin për siguri në komunikacionin rrugor. Nëse shoferi gjatë periudhës prej tri vitesh të fundit i arrin apo tejkalon 100 pikë negative në komunikacionin rrugor, gjykata do të shqiptojë sanksion të shfuqizimit të patentë shoferit në kategorinë e automjetit me të cilin ka arritur 100 pikë negative. Ndërsa kryerësit të cilit i është shqiptuar sanksioni i shfuqizimit të

¹²Neni 15: Ligji për kundërvajtje, 12.05.2006 – Republika e Maqedonisë

¹³ Neni 16: Po aty,

¹⁴ Neni 17: Po aty,

patentë shoferit, nuk mund ta marrë të drejtën e drejtimit të automjetit para kalimit të gjashtë muajve nga dita e shfuqizimit të patentë shoferit.¹⁵

Ndalim i drejtimit të automjetit

Për kundërvajtje kundër sigurisë në komunikacionin publik me të cilën shkaktohet rrezik për ndodhjen e pasojës së rëndë, përkatësisht me veprim shkaktohet pasojë e dëmshme, mund t'u shqiptohet sanksion i ndalimit të drejtimit të automjetit të llojeve apo kategorive të caktuara të automjeteve, në kohëzgjatje prej 30 ditësh deri në një vit. Për atë që nuk ka patentë shoferi, dhe kryen kundërvajtje, ndalimi i drejtimit të automjetit përfshin ndalim për marrjen e patentë shoferit në periudhë prej 30 ditësh deri në një vit. Ndalimi i drejtimit të automjetit evidentohet në dosjen e shoferit më së voni në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e vendimit dhe fillon të rrjedhë nga dita e evidentimit në patentë shoferin. Nëse sanksioni i shqiptohet personit që ka patentë shoferi të huaj për drejtim të automjetit, ky sanksion përfshin ndalimin e drejtimit të automjetit në territorin e RMV-së, për të cilën do të njoftohet policia kufitare.¹⁶

Ndalimi i ushtrimit të profesionit,

Kryerësit të kundërvajtjes mund t'i ndalohet ushtrimi i profesionit, veprimtarisë apo detyrës së caktuar apo punëve lidhur me disponimin, shfrytëzimin dhe menaxhimin me pronën apo për ruajtjen e kësaj prone, nëse e ka keqpërdorur profesionin, veprimtarinë apo detyrën e tij për shkak të kryerjes së kundërvajtjes dhe nëse në bazë të natyrës së kundërvajtjes dhe rrethanave në të cilat është kryer, mund të pritët se veprimtarinë e këtillë do ta keqpërdor për kryerje të sërishme të kundërvajtjes. Gjykata e përcakton kohëzgjatjen e ndalimit më së voni deri në një vit, duke llogaritur nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit. Organi i kundërvajtjes sanksionin mund ta shqiptojë në kohëzgjatje prej më së paku tri ditësh deri në më së shumti 30 ditë. Ndalimi mund të zëvendësohet me kompensim me para në rastet e përcaktuara me ligj, vetëm atëherë kur kundërvajtja e njëjtë është kryer për herë të parë.¹⁷

¹⁵ Neni 19: Ligji për kundërvajtje, 12.05.2006 – Republika e Maqedonisë,

¹⁶ Neni 20: Po aty,

¹⁷ Neni 21: Po aty,

Dëbimi i të huajit nga vendi

Gjykata kryerësit që nuk është shtetas i RMV-së mund t'ia shqiptojë sanksionin e dëbimit nga vendi kur do të vlerësojë se natyra e kundërvajtjes, motivet e kryerësit dhe rrethanat në të cilat është kryer, sugjerojnë në padëshirueshmëri për qëndrim të mëtejshëm të kryerësit në vend. Dëbimi i të huajit nga vendi mund të zgjasë prej një viti deri në dhjetë vjet apo përgjithmonë, dhe fillon të llogaritet nga dita e dëbimit të kryerësit nga territori i RMV-së. Për ato të cilët gëzojnë marveshje ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e RMV-së nuk mund t'ju shqiptohet ky sanksion, por vetëm vërejtje ose dënimi me gjobë.¹⁸

Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve (personave me sëmundje të varësisë)

Kryerësit të kundërvajtjes për shkak të varësisë nga përdorimi i përhershëm i pijeve alkoolike, drogave dhe substancave tjera psikotropike, kur ekziston rreziku që për shkak të kësaj varësie edhe më tutje të kryejë kundërvajtje, gjykata mund t'u shqiptojë mjekim të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve (personave me sëmundje të varësisë) në ambulancë apo në institucionin e specializuar të përcaktuar me ligj. Nëse kryerësi pa shkak të arsyeshëm nuk i nënshtrohet mjekimit të lirë në ambulancë apo mjekimin vullnetarisht e lëshon, gjykata mund të caktojë sanksion për mjekim të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve që detyrimisht të realizohet në institucionin e specializuar. Ky mjekim i detyrueshëm në institucionin e specializuar mund të zgjasë më së shumti dy vite.¹⁹

Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri

Kryerësi i kundërvajtjes i cili gjatë kohës së kryerjes së kundërvajtjes ka qenë në gjendje të papërgjegjshme apo me përgjegjshmëri të zvogëluar, gjykata do t'ia shqiptojë mjekim të detyrueshëm psikiatrik në liri, nëse konstaton se për shkak të gjendjes së këtillë mund të kryejë përsëri kundërvajtje, kurse për mënjanimin e këtij rreziku mjafton mjekimi i tij në liri. Mjekimi mund të zgjasë më së shumti gjashtë muaj.²⁰

¹⁸ Neni 22: Ligji për kundërvajtje, 12.05.2006 – Republika e Maqedonisë,

¹⁹ Neni 23: Po aty,

²⁰ Neni 24: Po aty,

Ndalimi për hyrje apo pjesëmarrje në ndeshje sportive

Gjykata do të shqiptojë sanksion ndalim për hyrje dhe pjesëmarrje në ndeshje sportive, nëse është kryer kundërvajtje në rastet e përcaktuara me ligj. Ndalimi për hyrje dhe pjesëmarrje në ndeshjet sportive mund të shqiptohet në kohëzgjatje më së shumti deri në tre vite.²¹

1.1.2. Sanksionet kundërvajtëse për fëmijë

Ndaj fëmijës që në kohën e kryerjes së kundërvajtjes nuk i ka mbushur 14 vjet nuk mund të zbatohen sanksionet kundërvajtëse.²² Për fëmijën që në kohën e kryerjes së kundërvajtjes i ka mbushur 14 vjet e nuk i ka mbushur 16 vjet (fëmija në konflikt me ligjin prej 14 deri në 16 vjet) mund t'i shqiptohen vetëm masa edukative. Fëmijës që në kohën e kryerjes së kundërvajtjes i ka mbushur 16 vjet e nuk ka mbushur 18 vjet (fëmija në konflikt me ligjin mbi 18 vjet) mund t'i shqiptohet masa edukative, e me përjashtim gjobë.²³

Për dallim nga kundërvajtësit madhorë, tek fëmijët shqiptohen vetëm këto dënime: Masa Edukative, Gjobë, Shqiptimi i masave edukative të kryesve të moshës madhore të kundërvajtjes që i kanë kryer si fëmijë, dhe Shqiptimi i sanksionit për kundërvajtje në varg.

1.1.3. Sanskione për kundërvajtje për persona Juridikë dhe tregtar individ

Për kundërvajtje të kryer nga persona juridikë dhe tregtar individ, mund t'u shqiptohen sanksionet në vijim: vërejtje, gjobë dhe ndalim i përkohshëm për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar.²⁴

1.1.4. Masat e posaçme të kundërvajtjes

Nga vetë fjala masat e posaçme të kundërvajtjes na paraqiten në raste të veçanta dhe në raste të nevojshme për tu shqiptuar, mirëpo nuk duhet haruar se edhe këto masa janë të parapara në mënyrë precize në ligj, e pikërisht ligji për kundërvajtje i RMV-së i ndan në këtë formë:

²¹ Neni 25: Ligji për kundërvajtje, 12.05.2006 – Republika e Maqedonisë,

²² Neni 32: Po aty,

²³ Neni 33: Po aty,

²⁴ Neni 38: Po aty,

konfiskimi i pronës dhe dobisë pronësore dhe marrja e sendeve, si dhe puna në dobi të përgjithshme.²⁵

Dëshiroj të potencoj se gjatë punimit të kësaj teze të magjistraturës është sjellur ligj i ri për kundërvajtjet, në të cilin sanksionet i ndan, si: 1. Sanksionet kundravajtëse për personat fizik, 2. Sanksionet kundravajtëse për personat juridik dhe 3. Masat e posaçme të kundërvajtjes. Të cilat në esencë nuk kanë asnjë ndryshim, nga sanksionet e parapara me ligjin e mëparshëm për kundërvajtje të RMV-së i vitit 2006.

1.2. Gjoba, nocioni dhe zhvillimi historik i saj

Në të drejtën ndëshkimore pra edhe në të drejtën kundërvajtëse edhe në të drejtën penale, dënimi me gjobë është njëri prej dënimeve më të vjetra në historikun e sanksioneve ndëshkimore. Dënimi me gjobë në lëmin kundërvajtës si dënim pasuror, është i njohur që në kohën antike, në mesjetë por edhe në shoqërinë bashkëkohore. Poashtu gjoba si dënim është njohur edhe në të drejtën zakonore shqipëtare, ku sipas të njëjtës gjoba është definuar në shumë të caktuar të hollash ose vlerash materiale që fajtori detyrohej ta paguante për vepra të ndryshme penale.²⁶ Ky lloj dënimi është zbatuar në kushtet e egzistencës së pronës private dhe të ndarjes së shoqëris në klasa.²⁷ Pra ky dënim është paraqitur me vet zhvillimin e shoqërisë njerzore, ku ky zhvillim ka ndikuar që dënimi me anë të gjobës të pësohen ndryshime radikale në kohë dhe në hapsirë.

Në botën bashkëkohore, por edhe në sistemin e dënimeve për kundërvajtje në RMV gjoba paraqet njërim prej dënimeve më të shpeshta, që u caktohet kryerësve të veprave kundërvajtëse në lëmin penal në praktikën gjyqësore të gjykatave të RMV-së, edhe atë jo vetëm si dënim kryesorë por edhe si zëvendësim i dënimit me burg. Dënimi me gjobë si sanksion kundërvajtës, duhet nënkuptuar detyrimin e kryerësve të veprës kundërvajtëse, pra detyrimin e të dënuarit që të paguajnë në favor të shtetit një shumë të hollash me aktvendim të plotëfuqish të gjykatës për kundërvajtje, brenda kufijve të përcaktuar me ligj,

²⁵ Neni 41: Ligji për kundërvajtje, 12.05.2006 – Republika e Maqedonisë

²⁶ Ismet Elezi: E drejta zakonore penale e Shqiptarëve, Tiranë, 1983, fq.131

²⁷ Po aty, fq.131

me dispozitë ligjore. Është dënim pasuror sepse është i drejtuar kundër pasurisë së kryersit të veprës kundërvajtëse.

Dënimi me gjobë është dënim më i lehtë në krahasim me dënimin me burg, pasi që nuk e privon kryersin e veprës nga liria, mirëpo ka raste ku dënimi me gjobë mund të godas shumë më rëndë kryersin e veprës kundërvajtëse se sa dënimi me burg, sepse mund të jetë e pararparë gjobë me vlerë shumë të lartë monetare, e cila në menyrë të drejtëpërdrejtë godet mirëqenien ekonomike qoftë tek personat fizik, qoftë tek ato juridik.²⁸

1.3. Gjoba si sanksion primar kundërvajtës sipas ligjit për kundërvajtje

Në lëminë kundërvajtëse gjoba është përcaktuar dhe shqiptohet si sanksion kryesor. E kemi cekur edhe më lartë, se kufijtë e përcaktimit të gjobës i hasim të rregulluara dhe përcaktuara edhe me anë të normave ligjore, por gjithnjë të bazuara në disa nga elementet dhe rrethanat e lartëpërmendura.

Sipas ligjit për kundërvajtje të RMV-së në nenin 17 ceket se gjoba për personin fizik përbëhet nga pagesa e shumës së përcaktuar me para që nuk mund të jetë më e vogël se 15 euro në kundërvlerë me denarë, e as më e madhe se 1 000 euro në kundërvlerë me denarë, ndërsa për personin përgjegjës në personin juridik dhe tregtarin individ është 30% nga gjoba e përcaktuar për personin juridik respektivisht tregtarin individ. Sa i përket personit zyrtar nuk mund të jetë më e vogël se 50 euro në kundërvlerë me denarë, e as më e madhe se 2 000 euro në kundërvlerë me denarë. Mirëpo në vet ligjin për kundërvajtje dhe ligjet e tjera materiale mund të përcaktohen shuma më të larta nga ato të lartpërmendura.

Në vendimin për kundërvajtje përcaktohet afati për pagesën e gjobës që nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë ditë e as më i gjatë se 30 ditë nga dita e vendimit të plotfuqishëm, përkatësisht vendimit përfundimtar. Në rastet e caktuara kur kryerësi nuk ka pronë të mjaftueshme, nuk është i punësuar, është i sëmurë nga ndonjë sëmundje dhe rrethana tjera të ngjashme që e arsyetojnë këtë, mund të lejohet që gjoba të paguhet në këste. Në këtë rast, do të caktohet mënyra e pagesës dhe afati i pagesës që nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë

²⁸ Bajram Ukaj: Kundërvajtjet në lëmin Penal - Leksione të autorizuara (Dispencë), Prishtinë 2010

muaj.²⁹ E nëse ndodh që kryerësi pjesërisht apo plotësisht nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurë tatimore.³⁰

1.4. Gjoba si sanksion kundërvajtës dhe procedurat për shqiptimin e këtij sanksioni sipas ligjeve tjera materiale, si psh: Ligji për Dogana, Ligji për Siguri në Komunikacionin Rrugor dhe Ligji për Pyjet

Në vitin 2005 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi ndryshimet kushtetuese, të cilat për herë të parë u krijua mundësia që në rastet e përcaktuara me ligj për një kundërvajtje të caktuar, përveç organeve gjyqësore sanksion të shqiptohet edhe nga një organ i administratës shtetërore, vendimi i të cilit do t'i nënshtrohen mbrojtjes gjyqësore në kushte dhe procedura të rregulluara me ligj.

1.4.1. Ligji për dogana

Ligji për dogana është njëri nga ato ligje materiale të vendit tonë, që me anë të dispozitave ligjore ka përcaktuar se veprat kundërvajtëse doganore pikspari janë të përcaktuara me këtë ligj, poashtu edhe me ligjin për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave nga pronësia intelektuale, ligji për akcizat dhe ligje të tjera, ku kundërvajtjet të caktuara janë dhënë në kompetencë drejtorisë doganore.³¹

Po ashtu me anë të dispozitave ligjore të këtij ligji është rregulluar edhe mënyra e mbajtjes së procedurës kundërvajtëse nga organet doganor, për veprat për të cilat ky organ është kompetent, si që thuhet: Kompetent për mbajtjen e procedurës për kundërvajtje dhe shqiptimin e sanksionit për kundërvajtje dhe të masës së veçantë për kundërvajtje të kryer doganore është organi për kundërvajtje i përcaktuar me Ligjin për Drejtorinë Doganore, ku neni 10 pika 6 përcakton se ndër kompetencat kryesore të drejtorisë doganore është edhe udhëheqja e procedurës kundërvajtëse, shqiptimi i masës kundërvajtëse, dhe masave të veçanta kundërvajtëse për kryerjen e veprës kundërvajtëse doganore, në bazë të ligjit si dhe inicimin e

²⁹ Neni 16: Ligji për kundërvajtje, 12.05.2006 – Republika e Maqedonisë

³⁰ Neni 17: Po aty,

³¹ Neni 2: Ligji për dogana, 30.05.2005– Republika e Maqedonisë së Veriut

procedurës për vepra penale të vërtetuara me ligj. Prej kësaj detyrimisht lind nevoja për rregullimine e formës së udhëheqjes së procedurës së lartëpërmendur për të aritur deri te shqiptimi i sanksioneve kundërvajtëse, ku në bazë të nenit 10-a pika 1 thuhet se “Për udhëheqjen e procedurës kundërvajtëse dhe shqiptimin e saknskioneve kundërvajtëse dhe masave të veçanta kundërvajtëse, për kryerjen e veprës kundërvajtëse doganore, kompetencë ekskluzive ka autoriteti doganorë kundërvajtës”. Me të njëjtin ligj përcaktohet se organi për kundërvajtje doganore e paraparë në paragrafin 1 të këti neni është drejtoria doganore ndërsa procedurën kundërvajtëse e udhëheqë **komisioni vendimmarës për kundërvajtje**, puna e të cilit poashtu rregullohet në bazë të ligjit për dogana. Në përbërjen e komisionit si Kryetari dhe anëtarët e komisionit ato duhet të jenë: zyrtarë doganorë dhe juristë të diplomuar, ndërsa kryetari i komisionit duhet të jetë jurist i diplomuar dhe të ketë mbaruar provimin e jurispondencës. Poashtu komisioni duke procesuar në procedurë kundërvajtëse i ndërmer dhe i sjellë vendimet e veta në bazë të ligjit për kundërvajtje dhe në bazë të ligjit për procedurë administrative.³²

Më lartë e cekëm se disa gjoba për vepra kundërvajtëse janë me vlera të lartë monetare, sa që lartësia e të njëjtave mund të krahasohet dhe mund të tejkaloj lartësinë e një gjobe që mund të shqiptohet për vepra penale. Të njëjtat na paraqiten edhe tek ligji për dogana ku dispozitat kundërvajtëse të ligjit për dogana parashohin gjoba në vlera të ndryshme edhe atë duke filluar nga gjoba në shumë prej 15.000 euro me kundërvlerë në denarë, do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik dhe tregtarit individual, i cili vepron në kundërshtim me normat e këtij ligji.

1.4.2. Ligji për siguri në komunikacionin rrugor

Në Maj 2006 u miratua Ligji për Kundërvajtje i RMV-së, duke kompletuar kështu kornizën ligjore të legjislacionit penal. Ky ligj bëri një dallim të qartë në juridiksionin e gjykatave dhe organeve të kundërvajtjes, prezantoi mjaft institucione të reja, dhe mori tiparin e karakterit reformator. Qëllimi i tij, ndër të tjera ishte ulja e shtypjes dhe rritja e parandalimit. Kjo u arrit përmes instituteve të reja të parashikuara nga ky ligj, siç janë: ndërmjetësimi, shlyerja, lëshimi i një urdhërpagese, etj. Poashtu paraqiste bazen ligjore për krijimin e mëtejshëm të organeve të kundërvajtjes në Ministrinë e Brendshme.

³² Neni 10-a, pika 2 dhe 6: Ligji për dogana, 30.05.2005– Republika e Maqedonis së Veriut

Sektor i Kundërvajtjeve është themeluar në Mars 2007 si një njësi e re organizative në Ministri. Ministria e Brendshme ishte organi i parë i administratës ku u sistemua një formë e tillë organizative dhe në të njëjtën kohë ishte e para që filloi të punojë dhe zbatojë zgjidhjet ligjore të miratuara tashmë. Në vitin 2015, kjo njësi organizative u ndryshua në një formë më të lartë organizative dhe u emërua Departamenti i Kundërvajtjeve, ndërsa sa i përket strukturës organizative dhe menyrës së funksionimit na paraqitet si ne vijm:

Departamenti për Kundërvajtje është një formë e veçantë organizative brenda Ministrisë së Brendshme e cila përmban gjithësej 2 Sektorë për Kundërvajtje, si: Sektori për Kundërvajtje - Shkup dhe Sektori për Kundërvajtje - për territorin e Republikës së Maqedonisë. Brenda sektorit për kundërvajtje - Shkup janë departamentet vijuese: Departamenti për kundërvajtje Shkupi 1, Departamenti për kundërvajtje Shkupi 2, Departamenti për kundërvajtje Shkupi 3, Departamenti për kundërvajtje Shkupi 4, Departamenti për kundërvajtje Shkupi 5, Departamenti për kundërvajtje Shkupi 6 dhe Departamenti për kundërvajtje Shkupi 7.³³

Brenda sektorit për kundërvajtje - për territorin e Republikës së Maqedonisë i ka këto departamente: Departamenti për kundërvajtje Kumanovë, Departamenti për kundërvajtje Veles, Departamenti për kundërvajtje Kavadarci, Departamenti për kundërvajtje Prilep, Departamenti për kundërvajtje Manastir, Departamenti për kundërvajtje Shtip, Departamenti për kundërvajtje Koçan, Departamenti për kundërvajtje Strumic, Departamenti për kundërvajtje Tetov 1, Departamenti për kundërvajtje Tetov 2, Departamenti për kundërvajtje Gostivar, Departamenti për kundërvajtje Kërçov dhe Departamenti për kundërvajtje Ohër.³⁴

Sa i përket bazës ligjore nga ku edhe ky organ mbështetet në veprimtarin e tij, e kemi Ligjin për kundërvajtje (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut me nr. 23.07.2015), i cili specifikon që organi për kundërvajtje zhvillon procedurë kundërvajtëse kur ligji përcakton kompetencë ekskluzive për sjelljen e tij, ndërsa organi për kundërvajtje ku është selia e personit juridik është kompetent për të kryer procedura kundërvajtëse kundër një personi juridik. Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut vendos për një konflikt juridiksioni midis gjykatave dhe organeve të kundërvajtjes.³⁵

Veprat kundërvajtëse të parapara me ligjin për siguri në komunikacion rrugorë janë veprat më të shpeshta kundërvajtëse, për të cilat shqiptohen dënime me gjobë dhe me të cilat

³³ <https://mvr.gov.mk/page/sector-za-prekrshoci>

³⁴ Po aty,

³⁵ Po aty,

qytetarët e vendit tonë ballafaqohen më së shumti. Duke pasur parasysh se çdo ditë të njejtët i nënshtrohen këtij ligji, me pjesmarjen e tyre të drejtëpërdrejtë në komunikacionin rrugorë qoftë si kalimtarë në këmbë, qoftë si drejtues të automjetve të kategorive të ndryshme. Për këto veprime kontrollet janë më të shpeshta dhe janë rrutinë e përditshme, dhe këto kontrolle kryhen nga njesitet policore përkatëse të cilët drejtpërsëdrejti dhe me anë të paisjeve adekuate dhe të përcaktura me ligj, konstatojnë shkeljet dhe inicojnë procedurë për zbatim të sanksioneve kundërvajtëse.

Me anë të Ligjit për sigurin në komunikacionin rrugor rregullon shumë aspekte të sigurisë dhe mbrojtjen e rrugëve, parimet themelore dhe marrëdhëniet e ndërsjellta të pjesëmarrësve dhe subjekteve tjera në komunikacionin rrugor. Në mënyrë më decide përmes këtij ligji rregullohet siguria dhe mbrojtja e rrugëve, parimet themelore dhe marrëdhëniet e ndërsjella të pjesëmarrësve dhe subjekteve tjera në komunikacionin rrugor; rregullat në komunikacionin rrugor; sistemi i shenjave të komunikacionit rrugor, pajisjet dhe sinjalizimi i rrugëve; detyrat në rast të fatkeqësisë në komunikacion; kandidatët për shoferë, shoferët, autoshkollat, qendrat e provimit dhe patentat e shoferit; aftësimi për drejtim dhe marrja e të drejtës së drejtimit të automjetit motorik dhe procedura e kundërvajtjes për fëmijë; masat e veçanta të sigurisë; organizimi dhe detyrat e këshillave për siguri të komunikacionit rrugor; evidencat dhe mbrojtja e të dhënave; dispozitat e kundërvajtjes dhe autorizimet për rregullat nënligjore.³⁶ Për urdhërpagesa të kundërvajtjes me gjobë në shumë prej 330 euro në kundërvlerë me denarë do t'i lëshohet pjesëmarrësit në komunikacion që vepron në kundërshtim me dispozitën nga paragrafi i parë i këtij neni.³⁷

Si organ shtërorë kompetent për sa i përket zbatimit të rregullave dhe masave që kanë të bëjnë me sigurinë në komunikacionin rrugorë, mbajtjen e evidencave të ndryshme si dhe me iniciimin dhe mbajtjen e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtjet për të cilat është caktuar si organ i kundërvajtjes me kompetencë për veprimin e tij në pajtim me ligjin, na paraqitet Ministria e punëve të brendshme në përputhje me nenin 5 të ligjit për siguri në komunikacion rrugorë.

Nga dispozitat ligjore të ligjit për siguri në komunikacionin rrugorë të cilat kanë paraparë sanksion-gjobë në vlera ta larta dhe për të cilat zakonisht hasen ankesat nga qytetarët, janë gjobat e parapara për tejkalimin e shpejtësisë së lejuar ku neni 36 i këtij ligji përcakton se:

³⁶ Neni 1: Ligji për Siguri në komunikacionin rrugor, 30.07.2015– Republika e Maqedonis së Veriut

³⁷ Neni 3: Po aty,

në rrugë publike jashtë vendbanimit, shoferi nukguxon të lëviz me automjetin me shpejtësi më të madhe se: - 130 km/h në autostradë; -110 km/h në rrugë të rezervuar për komunikacion memjete motorike dhe- 90 km/h në rrugë tjera.³⁸

Ndërsa për shkeljen e të njejtave si dënime kundërvajtëse janë parapara gjoba me të holla, ku për të njejtat Ministria e punëve të brendshme lëshon urdhërpagesë mandatore. Urdhërpagesë mandatore me gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë me denarë në procedurën mandatore do t'i jepet kryesit të kundërvajtjes, përkatësisht do t'i regjistrohen 65 pikë negative në pajtim me dispozitat e këtij ligji shoferit i cili jashtë vendbanimeve lëviz me shpejtësi më të madhe se 70 km/h mbi shpejtësinë e lejuar dhe i cili vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij neni. Krahas shumës së caktuar të gjobës, shoferit do t'i shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalesë përdrejtim të automjetit motorik në periudhë prej gjashtë deri në 12 muaj, me kushte dhe procedurë të caktuar me ligj.³⁹

Po ashtu tham se në kuadër të Ministrisë së punëve të brendshme është paraparë komision për Vendimmarrje për Kundërvajtje ku neni 385 pika 2 përcakton se: Komisioni përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë. Kryetari i komisionit është juristit i diplomuar me provim jurisprudence të kaluar, dhe përvojë pune prej të paktën gjashtë vjet në materien në fjalë, ndërsa anëtarët e komisionit kanë të kryer arsim të lartë dhe janë me përvojë pune prej të paktën katër vjet në materien në fjalë. Ndërsa me pikën 1 të po të njejtit nen janë paraparë rastet kur nëpunësi policor për kryerësin i cili nuk ka paraqitur provë për kryerjen e pagesës nga neni 384 të këtij ligji, do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para komisionit për vendimmarrje për kundërvajtje, të formuar nga ministri i punëve të brendshme ndërsa si mekanizëm juridik për ankesë kundër vendimit të Komisionit, mund të paraqitet ankesë para Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës për kundërvajtje.⁴⁰ Nenin 387 parasheh ato lloj veprash kundërvajtëse në komunikacionin rrugorë për të cilat nëpunësi policor do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente, pa i propozuar kryerësit të kundërvajtjes procedurë të përshpejtuar të barazimit, ku me automatizëm nënkupton atë që gjykata kompetente e përcakton lartësinë e gjobës në bazë të kritereve të përcaktuara me dispozitat e ligjit për kundërvajtje dhe në pajtim me gjobën e përcaktuar me këtë ligj.

³⁸ Neni 36: Po aty,

³⁹ Neni 36 pika 3: Ligji për Siguri në komunikacionin rrugor, 30.07.2015– Republika e Maqedonis së Veriut

⁴⁰ Neni 385: Po aty,

Fëmija si subjekt që përfshihet në grupacionin më delikat edhe në kundërvajtje mer pjesë dukshëm dhe se si do të veprojë ligji në këtë aspekt nuk është e panjohur duke pasur parasysh si në lëmit tjera. Tek kundërvajtjet të kryera nga fëmijët do të zbatohen dënime në pajtim me ligj të veçantë. Për kundërvajtje të kryer nga fëmija është kompetente gjykata. Për të gjitha çështjet që lidhen me pjesëmarrjen e shoferëve-fëmijë në komunikacionin rrugor në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat e këtij ligji.⁴¹

Lidhur me mjetet e realizuara nga gjobat për kundërvajtjet e kryera nga kundërvajtësit lidhur me sigurinë në komunikacionin rrugor, të gjitha arkëtohen në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.⁴²

1.4.3. Ligji për pyjet

Një nga ligjet materiale të kundërvajtjes që hasen gjoba të larta monetare është ligji për pyjet, andaj edhe të njëjtin e kemi marrë si shembull në këtë punim, ku poashtu edhe kodi penal në nenin 226 e parasheh veprën penale “Shkatrimi i pyjeve”.

Si shembull i lartësisë së gjobave për personat juridik në këtë ligj është paraparë gjobë në shumë prej 25.000 deri në 30.000 euro në kundërvlerë denarë, e cila do t’i shqiptohet personit juridik për kundërvajtje në rastë të kryerjes dhe moskryerjes së veprimeve të parapara në këtë dispozitë ligjore.⁴³ Sa i përket sanksioneve kundërvajtëse ose gjobat për personin fizik janë maramendëse, edhe atë duke filluar prej 3.500 deri 4.000 euro në kundërvlerë denarë në rastë të kryerjes dhe moskryerjes së veprimeve të parapara në këtë dispozitë ligjore.⁴⁴ Ndërsa afati i parashkrimit të procedurës kundërvajtëse qoftë për personat juridik qoftë për ato fizik është pesë vite.⁴⁵

Kodi penal parasheh si vepër penale “Dëmtimin e pyjeve” ku si objekt mbrojtës ka pyjet si e mirë natyrore dhe ekonomike.⁴⁶ Në nenin 226 kodit penal thotë: Një person i cili në kundërshtim me rregulloren ose urdhërin nga autoritetet kompetente ose organizatat kryejnë konvertimin, prerjen ose gërmimin e pyjeve ose zbardhjen e pemëve ose përndryshe shkatron

⁴¹ Neni 393-a dhe b: Ligji për Siguri në komunikacionin rrugor, 30.07.2015– Republika e Maqedonisë së Veriut,

⁴² Neni 389: Po aty,

⁴³ Neni 101: Ligji për pyje, 10.05.2018- Republika e Maqedonisë së Veriut,

⁴⁴ Neni 104: Po aty,

⁴⁵ Neni 107: Po aty,

⁴⁶ Neni 206: Kodi penal – Tekst i konsoliduar 2020 - Republika e Maqedonisë së Veriut,

pyellin, do të gjobitet ose burgoset deri në tre vjet. Nëse bëhet fjalë për ndonjë veprë që është kryer në një pyll të mbrojtur, park kombëtar ose në një pyll tjetër me qëllim të veçantë, kryesi do të dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Një person që kryen krimin apo çfarëdo dëmtimi në pyllin e tij, dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit. Mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale në pyll do të konfiskohen.

1.5. Shqiptimi dhe matja ligjore e gjobës sipas ligjit për kundërvajtje

Gjobën e shqipton Gjykata ose organet kundërvajtëse, dhe ata janë të obliguar që kryerësit të kundërvajtjes ti përcaktohet sanksioni për kundërvajtjen e kryer në kufijtë e parapar me ligj dhe duke vlerësuar përgjegjësinë e tijë për veprën e kryer si dhe peshën e saj.

Gjatë përcaktimit të gjobës për kundërvajtjen e kryer gjithëmon gjykata ose organi kundërvajtës është i detyruar ti vlerësojë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë që gjoba e shqiptuar të jetë më e lehtë për personin e shpallur fajtor, dhe duke i shqyrtuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduse, e veçanërisht: shkallën e përgjegjësisë së kryerësit për kundërvajtje, fajin, shkallën e rrezikshmërisë ose cënimit të sëmirës së mbrojtur, rrethanat me të cilat është kryer kundërvajtja, jeta e mëparshme e kryerësit, situatat e tij personale dhe sjellja e tij pas kundërvajtjes veçanërisht nëse e ka kompensuar dëmin, si dhe rrethanat tjera që kanë të bëjnë me personalitetin e kryerësit. Gjykata ose organi kundërvajtës gjatë shqiptimit të gjobës duhet patur parasysh gjendjen pasurore të kryerësit, lartësinë e pagës së tij, pronën e tij, të ardhurat tjera dhe obligimet tjera familjare, tek kundërvajtjet edhe nga fusha e tatimeve dhe doganat dhe proporcionaliteti i lartësisë së detyrimeve të papaguara për të cilat është i obliguar me ligj.

Si rrethanë vështirësuese nuk mund të llogariten sanksionet për kundërvajtje të shqiptuara për kundërvajtje paraprakisht të kryer, nëse nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit për kundërvajtje deri në kryerje të kundërvajtjes së re kanë kaluar më shumë se një vit.

Për kundërvajtjet e kryera nga lakmia, apo për kundërvajtjet me të cilat shkaktohet dëmi i madh pronësor, mund të përcaktohet gjobë deri në shumën e dyfishit ose të trefishtit nga gjoba e parapar, ose në përpjesëtim me lartësinë e dëmit të shkaktuar apo dobisë së marrë. Ndërsa për kundërvajtjet na lëmia e konkurrencës dhe energjetikës, gjoba do të shqiptohet në bazë të të

hyrave deri në 10% nga të hyrat e personit juridik.⁴⁷ Për kundërvajtje për të cilën shqiptohet gjobë me lëshimin e urdhërpagesës mandatore, mund të përcaktohet shumë e përcaktuar që për personat fizikë nuk mund të jetë më e madhe se 500 euro në kundërvlerë me denarë dhe për personin zyrtar nuk mund të jetë më e madhe se 1 000 euro në kundërvlerë me denarë.

1.5.1. Afati për pagesën e gjobës

Edhe më lartë e cekur se ligji për kundërvajtje thot se në vendimin për kundërvajtje përcaktohet afati për pagesën e gjobës që nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë ditë e as më i gjatë se 30 ditë nga dita e vendimit të plotfuqishëm, përkatësisht vendimit përfundimtar.⁴⁸ Në rastet e caktuara kur kryerësi nuk ka pronë të mjaftueshme, nuk është i punësuar, është i sëmurë nga ndonjë sëmundje dhe rrethana tjera të ngjashme që e arsyetojnë këtë, mund të lejohet që gjoba të paguhet në këste. Në këtë rast, do të caktohet mënyra e pagesës dhe afati i pagesës që nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj.⁴⁹

1.5.2. Realizimi i gjobës dhe lirimi nga sanksioni

Nëse kryerësi pjesërisht apo plotësisht nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e ligjit për procedurë tatimore.⁵⁰ Në nenin 29 të këtij ligji gjykata, përkatësisht organi i kundërvajtjes mund ta lirojë nga sanksioni kryerësin e kundërvajtjes vetëm kur kjo është shqiptuar në mënyrë të prerë dhe e përcaktuar me ligj. Kur gjykata, përkatësisht organi i kundërvajtjes është i autorizuar që kryerësin e kundërvajtjes ta lirojë nga sanksioni, mund t'ia zbusë gjobën pa kufizime të përcaktuara për zbutjen e gjobës, ose vetëm nga sanksioni ndalim i drejtimit të automjetit apo dëbim i të huajit nga vendi.⁵¹

⁴⁷ Neni 36: Ligji për kundërvajtje, 12.05.2006 – Republika e Maqedonisë

⁴⁸ Neni 16: Po aty,

⁴⁹ Po aty,

⁵⁰ Neni 17: Po aty,

⁵¹ Neni 29: Po aty,

1.5.3. Baza e posaçme për lirim nga sanksioni

Bazat e posaçme për lirim nga sanksioni janë ato baza ku gjykata, përkatësisht organi i kundërvajtjes mund ta lirojë nga sanksioni kryerësin e kundërvajtjes së kryer nga pakujdesia, atëherë kur pasojat e kundërvajtjes kryerësin e godasin aq rëndë, sa që shqiptimi i sanksionit në rastin e këtillë nuk do t'i përgjigjet qëllimit të sanksionimit.

Kapitulli i II

2. Sanksionet penale ne përgjithësi, nocioni, zhvillimi historik dhe llojet

Sanksionet penale janë pjesa që më së shumti ka pësuar ndryshime, të cilat ndryshe njihen si masa shtrënguese penalo-juridike të parapara me kodin penal, e të cilat shqiptohen nga gjykata në procedurë të rregullt gjyqësore ndaj kryerësve përgjegjës të veprave penale. Qëllimi i sanksioneve penale i ka dy komponenta: a) parandalimi i veprës penale – i cili ndryshe njihet edhe si special, këtu bëjnë pjesë frika, resocializimi, shërimi dhe edukimi, dhe b) gjeneral – mbrojtja e shoqërisë në përgjithësi nga kriminaliteti.

Sa i përket masave të sanksioneve penale ato na paraqiten në dy vlera të cilat janë të ndërlidhura ndërmjet vete, të cilat janë: masa parandaluse dhe masa represive.

Sanksionet penale poashtu kanë edhe karakteristika themelore,⁵² si: a) Mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti; b) I'u shqiptohen vetëm kryerësve të veprave penale; c) Parimi “nullum crimen, nulla poena, sine Lege” që do të thotë se askush nuk mund të ndëshkohet për ndonjë veprim i cili nuk është parapar me ligji si vepër penale apo veprim i ndaluar; d) Shqiptohen vetëm nga gjykata; dh) Kryerësve i'u merren, kufizohen disa të drejta dhe liri.

2.1. Nocioni

Sanksioni është masë penalo juridike apo ndëshkuese, që kryerësit ia shqipton gjykata, nëpërmjet vendimit gjyqësor të detyrueshëm, i përcaktuar me ligj si reaksion për veprën e kryer. Nga termi sanksion penal – juridik, rjedhin elementet në vijim: *e para* se ajo është pasojë juridike që e godet kryerësin për shkak të kryerjes së veprës penale, *e dyta* është se sanksioni penal-juridik është masë e detyruar që e shqipton gjykata, dhe *e treta* është se përbëhet në marjen ose në kufizimin e disa të drejtave dhe lirive të kryerësit ose shërimin e detyruar ose trajtimin në liri, poashtu edhe masa të ndihmës dhe mbrojtjes.⁵³

⁵² Ismet Salihu: E drejta penale, pjesa e përgjithshme – Prishtinë, 2012, fq.415-416

⁵³ Vlado Kambovski: E drejta penale, Pjesa e përgjithshme – Shkup, 2007, fq.447

Sanksionet penale janë masa të dhunëshme penalo juridike të cilat i shqiptonë gjykata në procedurën e përcaktuar me ligj, ndaj kryerësit të veprës penale, me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë dhe individit nga kriminaliteti, ndërsa konsistojnë në marrjen apo kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara apo në tërheqjen e vërejtjes së kryerësit se do t'i merren apo kufizohen liritë dhe të drejtat, nëse sërish kryen vepër penale.⁵⁴

2.2. Zhvillimi historik

Sanksionet penale në kuptimin e plotë të fjalës lajmërohen pas paraqitjes dhe themelimit të shteteve të para dhe institucionve të tyre. Në këtë drejtim disa lloje të reagimev ndaj sjelljeve kriminale të cilat egzistonin në shoqërinë primitive, fillojnë dalëngadalë të shuhen ose të transformohen në dënime tjera. Pas themelimit të shtetit dhe organizimit të pushtetit dhe institucioneve shtetërore, hakmarrja si formë e ragimit në shoqëritë primitive nëpërmjet parimit të talionit dalëngadalë shëndërrohet në dënim me vdekje, ndërsa kompozicioni transformohet në dënim pronësor, në rend të parë si dënim me gjobë.⁵⁵

Evulimi dhe zhvilimi i sanksioneve penale ka shkuar krahas zhvillimit të së drejtës penale, e cila ka kaluar në disa etapa. Me reformën e parë të së drejtës penale, ku rëndësi të posaçme i jepet sanksionit penal – dënimit i cili ishte sanksion i vetëm, edhe atë dënimi me burg si dënim dominues. Me reformat e më vonshme ka fillimi i shekullit 20 paraqitet nevoja që sanksionet të jenë dualistike, dhe përpos dënimit si sanksion penal të parashihen edhe masat siguruse. Ndërsa më vonë sistemi bashkëkohor i sanksioneve është modeluar si sistem pluralist, ku përveç dënimit si sanksion themelorë njihen edhe 3 lloje tjera të sanksioneve penale, siç janë: masat alternative; masat siguruese; masat edukuese.

Sipas mendimit tim për një evulim të shpejt, e veçanarisht kohëve të fundit si fillimi i shekullit 21, rolë të madh ka luajtur edhe vetë zhvillimi i shoqërisë mbi veprën penale, shtetet dhe rregullimi i tyre si dhe politika e tyre mbi dënimet, shkenca mbi kriminalitetin dhe aspektet sociale për të njetat dukuri, që kohëve të fundit përparësi më të madhe gjatë shqiptimit të sanksionit i jepet masave alternative dhe masave siguruse edukuese, për arsye se në praktik vërtetohet se me masat alternative më së miri arihet deri te qëllimi i dënimit, si për institucionet

⁵⁴ Ismet Salihu: E drejta penale, pjesa e përgjithshme – Prishtinë, 2012, fq.415

⁵⁵ Ragip Halili: Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale – Prishtinë, 2014, fq.85

që kanë për detyrë të vendosin barazi apo kthimin në gjendje para se të kryhet vepra (restitution in integrum), si dhe për vetë kryerësin të arrihet më mirë riedukim dhe risocializimi i tijë, që në të ardhmen të zvoglohen sjelljet e tilla.

2.3. Llojet e sanksioneve penale

Sanksionet penale janë polivalente për nga funksionet e tyre dhe pluraliste për nga llojet dhe struktura e tyre. Pa marrë parasyshë dallimet terminologjike në emërtimin e sanksioneve penale sipas kodeve penale të shteteve të ndryshme ato mund të ndahen në: a) Dënime, b) Dënime alternative ose masa të ndryshme të zëvendësimit të dënimeve, c) dënime plotësuese – dënime plotësuese si sanksione të veçanta penale që aplikohen ndaj delikuentëve të rrezikshëm, nga shprehitë ose ndaj delikuentëve professional dhe d) Masat Edukative korrektuese si sanksione të veçanta penale ndaj delikuentëve të mitur. Sanksionet penale në sistemin bashkëkohor të ndëshkimit kanë karakter dualist, pra ndaj kryerësve të veprave penale mund të shqiptohen edhe ekzekutohen dënimet dhe zëvendësimet e tyre, si p.sh. dënimi me kusht dhe vërejtja gjyqësore, ose edhe sanksione tjera të tipit të mbrojtjes të cilat kanë karakter preventiv.⁵⁶

Në fund të shekullit 19, evolucioni i së drejtës penale shpjen në zbutjen, humanizmin dhe reagimin e shtetit ndaj kryerësve të veprave penale, dhe në inagurimin e disa llojeve të reja të sanksioneve penale, mirëpo mjaft efektive që të mbrohen interesat e qytetarëve, si dhe interesat kombëtare e ato shtetërore. Këto janë dy lloje të sanksioneve penale: *Dënimi me kusht* dhe *Vërejtja gjyqësore*.⁵⁷

2.4. Sanksionet penale sipas Kodit penal të RM-së

Sistemi i sanksioneve penale paraqet përmbledhje të sanksioneve të vërtetuara në ligj, të cilat në bazë të kushteve të caktuara dhe pas realizimit të procedurës, mund t'i shqiptohen kryesit të veprës penale.⁵⁸ Sistemi i sanksioneve i paraparë në kodin penal të RMV-së me shënimet e jashtme i ka të gjitha karakteristikat e sistemit pluralist, por ai është pluralist vetëm

⁵⁶ Ragip Halili: Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale – Prishtinë, 2014, fq.66-67

⁵⁷ Ismet Salihu: E drejta penale, pjesa e përgjithshme – Prishtinë, 2012, fq.417

⁵⁸ Stefan Buxhakoski: Kazneno Pravo, opsht del – Ohër, 2014, fq.268

sipas strukturës formale të tij, e komponuar nga më shumë lloje sanksionesh, pasi në themel bëhet fjalë për sistem mirë të integruar të sanksioneve të unifikuara dhe të konceptuara mbi dënimin si sanksion themelor.⁵⁹ Sipas kodit penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut sanksionet penale ndahen në katër lloje: 1.Dënimet, 2.Masat alternative, 3.Masat siguruse dhe 4.Masat edukuese.⁶⁰

2.4.1. Dënimet

Dënimi është sanksion juridiko-penal, të cilin e shqipton gjykata në procedurë të caktuar me ligj, ndaj kryerësve të veprave penale penalisht të fajshëm me qëllim të luftimit të kriminaliteti, mbrojtjes së vlerave më vitale të individit dhe shoqërisë, e cila konsiston në marrjen ose kufizimin e të drejtave të caktuara kryerësit të veprës penale për veprën penale të kryer.⁶¹ Dënimi konsiderohet si kthim i drejtësishëm për veprën e kryer, në fakt e keqe e paramenduar dhe e qëllimshme që i shkaktohet kryerësit për veprën e kryer dhe në kornizat e fajsis për veprën.

Në teorinë e së drejtës penale, por edhe në praktikën gjyqësore, kuptimi i dënimit përkufizohet duke marrë për bazë elementet juridike të dënimit, por edhe duke marrë për bazë qëllimet, të cilat dëshirohen të arrihen, me rastin e shqiptimit të tyre.⁶² Qëllimi i dënimit mund të jetë i *përgjithshëm* – mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe veprat tjera themelore të njeriut nga veprat penale, si dhe qëllim i *posaçëm* - përveç realizimit të së drejtës, qëllimi i dënimit është: 1) pengimi i kryerësit të kryej vepra penale dhe riedukimi i tij dhe 2) në mënyrë edukative të ndikojë mbi të tjerët që të mos kryejnë vepra penale. Dënimet shqiptohen ndaj personave madhor dhe të cilët janë penalisht të përgjegjshëm për veprën penale të kryer.

Deri në vitin 2004 legjislacioni ynë penal njihnte vetëm dy lloje të dënimeve: dënimin me burgim dhe dënim me të holla (gjobë), mirëpo me ndryshimet që ndodhën pas vitit 2004 repertori i dënimeve u zgjerua edhe me disa dënime tjera. Sipas kodit penal të RMV-së njihen gjashtë lloje të dënimeve, ku kryerësve të veprave penale mund t'u shqiptohen dënimet si vijojnë⁶³:

⁵⁹ Vlado Kambovski: E drejta penale, Pjesa e përgjithshme – Shkup, 2007, fq.458

⁶⁰ Neni 4: Kodi penal i RMV-së, Tekst i konsoliduar – Tetor 2020

⁶¹ Bajram Ukaj: Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë – Prishtinë, 2006 fq.211

⁶² Bajram Ukaj: Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë – Prishtinë, 2006 fq.211

⁶³ Neni 33: Kodi penal i RMV-së, Tekst i konsoliduar – Tetor 2020

- 1) Dënim me burg;
- 2) Dënim me para (në të holla);
- 3) Ndalimi i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 4) Ndalimi i drejtimit të automjetit;
- 5) Dëbimi i të huajit nga vendi, dhe
- 6) Ndalim për ndjekje të ndeshjeve sportive.

Dënimet sipas kodit penal të RMV-së ndahen në dënime: A) kryesore, si: 1.Burgu dhe 2.Gjoba, dhe B) sekondare, si: 1.Ndalimi i ushtrimit së profesionit, veprimtarisë ose detyrës; 2.Ndalimi i drejtimit te automjetit; 3.Dëbimi i te huajit nga vendi; dhe 4.Ndalim për ndjekje të ndeshjeve sportive.

Dënimi me burg mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesor, ndërsa dënimi me para mund të shqiptohet si dënim kryesor dhe plotësues bashkërisht me dënimin me burg ose me dënimin me kusht me të cilin është përcaktuar dënimi me burg. Nëse për një vepër penale është paraparë dënim me burg ose dënimme para, si dënim kryesor mund të shqiptohet vetëm njëra nga ato, përveç kur me ligj është rregulluar se mund të shqiptohen edhe të dy dënimet. Bashkërisht me dënimin kryesor mund të shqiptohet një ose më tepër dënime plotësuese, sipas kushteve të parapara për shqiptimin e tyre me ligj. Me ligj mund të rregullohet edhe shqiptimi i obligueshëm i dënimit plotësues.⁶⁴

Dënimi ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës mund të shqiptohet vetëm si dënim plotësues bashkërisht me dënimin me burg ose me dënimin me kusht me të cilin është përcaktuar dënim me burg. Dënimet ndalim i drejtimit me automjet dhe dëbimi i të huajit nga vendi mund të shqiptohen nëse kryerësit i është shqiptuar dënim me burg ose dënim me para, dënim me kusht ose vërejtje gjyqësore. Dënimi ndalim i drejtimit me automjet mund të shqiptohet edhe si dënim i vetëm i kryerësit për vepër pakujdesie, për të cilën është paraparë dënim me para ose dënim me burg prej një viti, nëse veprën e ka bërë nën kushte të veçanta lehtësuese.⁶⁵

Dënimi ndalim për ndjekje të ndeshjeve sportive mund t'i shqiptohet nëse të gjykuarit i është shqiptuar dënim me burg, dënim në para, dënimme kusht ose vërejtje gjyqësore. Ndërsa sa i përket ligjshmërisë për shqiptimin e dënimit, kryerësit të veprës penale i shqiptohet dënimi

⁶⁴ Neni 33: Kodi penal i RMV-së, Tekst i konsoliduar – Tetor 2020

⁶⁵ Neni 33: Kodi penal i RMV-së, Tekst i konsoliduar – Tetor 2020

i caktuar për veprën penale të kryer, ndërsa dënim më i butë nga i caktuari mund të shqiptohet vetëm nën kushtet e parapara me këtë Kod. Për vepra penale të kryera për shkak të interesit dënimi me para si dënim plotësues mund të shqiptohet edhe kur nuk është caktuar me ligj ose kur me ligj është caktuar se kryesi do të dënohet me burg ose me dënim me para, ndërsa gjykata si dënim kryesor do të shqiptojë dënim me burg.⁶⁶

Ajo që na intereson më së shumti neve është dënimi me para (me gjobë) të cilin më poshtë do ta trajtojmë në mënyrë më të detajuar.

2.4.2. Masat alternative

Masat alternative japin mundësinë e zgjedhjes në lidhje me dënimin që duhet vuajtur. Ndryshe thënë janë dënime që i mundësojnë kryerësit që një pjesë ose gjithë dënimin ta vuaj në bashkësi, jashtë institucioneve të burgut. Në të kaluarën nuk kanë qenë të zbatueshme këto lloj masa, ndërsa tani me përkrahjen e OKB-së janë dukshëm në zbatim, e sidomos rregullat dhe standardet ndërkombëtare të bazuara në qëndrimet se dënimi paraqet mjet të fundit dhe se duhet të stimulohen masat joburgosëse që sigurojnë ekuilibër në mes të drejtës së kryerësit, të drejtat e viktimës dhe interesit të shoqërisë.⁶⁷

Qëllimi i masave alternative është që ndaj kryerësit të veprës penale të mos zbatohet dënimi për vepra më të lehta, kur ajo nuk është e detyrueshme për shkak të mbrojtjes të së drejtës penale dhe kur mund të pritët se qëllimi i dënimit mund të realizohet me tërheqjen e vërejtjes, me kërcënim të dënimit (dënim me kusht), vetëm paralajmërim (vërejtje gjyqësore) ose me masën e ndihmës dhe mbikëqyrjen e sjelljes të kryerësit në liri.

Sistemi i masave alternative i kodit penal të RMV-së i parasheh këto lloje të dënimeve:

1. Dënimi me kusht;
2. Dënimi me kusht nën mbikëqyrje të shtuar;
3. Puna në dobi të përgjithshme;
4. Ndërprerja me kusht e procedurës penale;

⁶⁶ Neni 34: Kodi penal i RMV-së, Tekst i konsoliduar – Tetor 2020

⁶⁷ Vlado Kambovski: E drejta penale, Pjesa e përgjithshme – Shkup, 2007, fq.561

5. Vërejtja gjyqësore;
6. Burgu shtëpiak.⁶⁸

2.4.3. Masat siguruese

Masat e sigurisë janë sanksione të lidhura për rezikun e kryerësve dhe qëllimi i tyre është preventiva, largimi nga gjendja e reziqshme. Qëllimi i masave të sigurisë është që të mënjanohen gjendjet dhe kushtet që mund të ndikojnë që kryesi në të ardhmen të kryej vepra penale.⁶⁹ Këto masa zbatohen në kushte të caktuara ligjore – Regjimi ligjor, kodi penal i RMV-së parasheh dy lloje regjimesh: e para është kur të njëjtat i'u shqiptohen kryerësve të përgjegjshëm të veprave penale; dhe e dyta kur u shqiptohen personave me përgjegjësi të zvogluar, alkoolistëve dhe narkomanëve.

Kodi penal i RMV-së i parasheh këto lloje të masave të sigurisë:

1. Mjekimi i detyruar psikiatrik dhe ruajtje në institucionin shëndetësor;
2. Mjekimi i detyruar psikiatrik në liri;
3. Mjekimi i detyruar i alkoolistëve dhe narkomanëve; dhe
4. Mjekimi medicinalo farmakologjik - i kryesve të sulmit seksual mbi një fëmijë deri në moshën 14 vjeçare.

Shqiptimi i masave të sigurisë rregullohet me nenin 62 të kodit penal të RMV-së sipas të cilit: Kryesit të veprës penale gjykata mund t'i shqiptojë një ose më shumë masa të sigurisë, kur ekzistojnë kushte për shqiptimin e tyre të paraparamë në këtë Kod. Mjekimi i detyruar psikiatrik dhe ruajtja në institucionin shëndetësor dhe mjekimi i detyruar psikiatrik në liri, i shqiptohen kryesit të veprës penale i cili është i paaftë për të gjykuar në mënyrë të pavarur.

Me vendimin për shqiptimin e masave nga paragrafi lartë, gjykata mund të përcaktojë ndalim të përkohshëm për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, ose ndalimin e drejtimit me automjet, të cilat zgjasin deri sa zgjat zbatimi i masave. Vendimi i gjykatës dërgohet deri te organi kompetent ose personi juridik në të cilin kryerësi është i punësuar, në gjykatën ose në organin i cili është kompetent për kryerjen e mbikëqyrjes për zbatimin e ndalimit për drejtim të automjetit. Shërimi psikiatrik i detyrueshëm dhe ruajtja në institucion

⁶⁸ Neni 48a: Kodi penal i RMV-së, Tekst i konsoliduar – Tetor 2020

⁶⁹ Neni 60: Kodi penal i RMV-së, Tekst i konsoliduar – Tetor 2020

shëndetësor dhe shërimi i detyrueshëm psikiatrik në liri i shqiptohen kryerësit, stabiliteti i të cilit dukshëm do të zvoglohet nëse i shqiptohet dënimi me burg, dënim me kusht me të cilin është vërtetuar dënimi me burg ose dënimi me kusht me mbikëqyrje të mbrojtur.

Shërimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve, mund të shqiptohet nëse kryerësit i është shqiptuar dënimi, dënim me kusht, dënim me kusht me mbikëqyrje të mbrojtur, vërejtje gjyqësore ose lirim nga dënimi. Mjekim mjekësor-farmakologjik mund t'i shqiptohet kryerësit të sulmit seksual mbi fëmijë deri në 14 vjet nëse i është shqiptuar dënim me burg.

2.4.4. Masat edukuese

Masat edukative janë masa qëllimi i të cilave është që të kontribuojë në rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat të kryerësit të mitur, duke ofruar mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje, poashtu duke siguruar edukim dhe aftësim profesional, duke zhvilluar përgjegjësinë e tij personale dhe kështu duke ndaluar sjelljen recidiviste. Qëllimi i masave edukative është dhënia e ndihmës dhe mbikëqyrjes së kryerësve të mitur të veprave penale me qëllim të risocializimit dhe edukimit të tyre.⁷⁰

Masat edukative kanë për qëllim të fundit që i mituri, pas zbatimit të masës së shqiptuar edukative të fillojë të veprojë në përputhje me rregullat ligjore, dhe në instancë të fundit të evitohet mundësia që ai të shndërrohet në recidivist, ku ato janë masa shtrënguese shtetërore të cilat kanë disa karakteristika si:

- a) Shqiptohen vetëm nga gjykata;
- b) Shqiptohen pavarësisht nga gatishmëria dhe vullneti i të miturit për ta respektuar;
- c) Konsistojnë në kufizimin e disa të drejtave dhe lirive të të miturve të cilët vendosen në institucione edukuese, duke imponuar një regjim të veçantë jetese;
- d) Nuk kanë pasoja juridike në statusin e të miturit ndaj të cilit janë shqiptuar, dhe nuk regjistrohen në regjistrin gjyqësor;
- dh) Lartësia e tyre nuk mund të jetë më e lartë se sa dënimi i paraparë për atë vepër penale.⁷¹

⁷⁰ Ismail Zejneli: Delikuenca e të miturve, Tetovë/Prishtin, 2018, fq.173

⁷¹ Taulant Bajrami: Masat ndaj të miturve delikuentë në Kosovë, shih - <http://centrum.mk/wp-content/uploads/2017/06/Taulant-Bajrami.pdf> fq.295

Sipas ligjit për të drejtën e fëmijëve kemi disa lloje të masave edukative: Fëmijës mbi moshën 14 vjet për veprime që me ligj është paraparë si vepër penale që mund t'i shqiptohen masat edukuese në vijim:

- masa qortim ose dërgim në qendrën për fëmijë,
- masat e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e prindit/ëve, ose tutorit/ëve, familja përkujdesëse ose qendra,
- masat e entit dërgim në institucione edukuese ose në shtëpi edukuese-përmirësuese.⁷²

Masa paralajmërim ose dërgim në qendrën për fëmijë i kumtohet fëmijës kur nuk ekziston nevoja për masa më të gjata të edukimit, e në veçanti nëse ka kryer veprim me të cilat me ligj është paraparë si vepër penale nga pamaturia ose mendjehetësia. Masat e mbikëqyrjes së shtuar i shqiptohen fëmijës kur ekziston nevoja nga masa më të gjata të edukimit, riedukimit ose mjekimit me mbikëqyrje përkatëse, e nuk nevojitet ndarje e plotë e tyre nga mjedisi i deritanishëm. Masat e entit i shqiptohen fëmijës kur ekziston nevoja nga masa të gjata të edukimit, riedukimit ose mjekimit dhe veçim të plotë nga mjedisi i deritanishëm. Kohëzgjatja e këtyre masave nuk mund të jetë më e gjatë se pesë vjet, por më së shumti deri më mbushjen e 23 viteve.⁷³

2.5. Dënimi në të holla (me gjobë)

Dënimi në të holla bën pjesë në llojet e dënimeve pasurore. Është dënim në pasuri që përbëhet në imponimin e të dënuarit me obligim penalo-juridik, për të paguar shumë të caktuar të hollash ndaj shtetit, për veprën penale të cilën e ka kryer. Qëllimi i dënimit me të holla është që kryesit të veprës penale t'i bëhet me dije në mënyrë serioze se ka kryer vepër të kundërligjshme dhe njëherit që për një kohë të caktuar të godasë standardin e tij jetësor, goditje kjo e cila në mënyrën e tanishme të jetës, në kushtet e shoqërisë konsumuese, ka rëndësi të madhe.⁷⁴

Ky dënim ka edhe përparsit edhe mangësit e tij:

Si **Përparsi** të këtij dënimi llogariten: largohen efektet negative të burgut: 1. Nuk e sjell në ryzikë të dënuarin, siç është rasti me të dënuarin kur privohet nga liria me dënimim me burg

⁷² Neni 37: Ligji për drejtësi për fëmijë, Tekst i konsoliduar – Gazeta zyrtare nr.148/2013

⁷³ Neni 37: Ligji për drejtësi për fëmijë, Tekst i konsoliduar – Gazeta zyrtare nr.148/2013

⁷⁴ Ismet Salihu: E drejta penale, pjesa e përgjithshme – Prishtinë, 2012, fq.446

(shoqëria e keqe, izolimi nga familja, nuk bie ndesh për keqpërdorime seksuale, mbrojtja nga infektimet kriminale në burg, dhe mbrojtja nga ndërprerja e punës); 2. Për recidivistët të cilët burgju u është shëndruar në shprehi, dënimi me të holla është më i rëndë për ta; 3. Dënimi me të holla është i dobishëm për shtetin: sjell të ardhura në vend të shpenzimeve të cilat janë të nevojshme për zbatimin e dënimit me burg; 4. Dënimi me të holla është më i mirë për kryesit i cili veprat i ka kryer nga pangopshmëria; 5. Ky dënim është më i lehtë për tu përmisuar në rast se është shqiptuar vendim i sjellur padrejhtësisht; 6. Dënimi me të holla ka përparsi të përcaktuara edhe ndaj dënimit me kushtë, për arsye se i dënuari më tepër e ndjen në financat e tijë; 7. Ky dënim nuk paraqet privilegj për të pasurit duke pasur parasysh matjen gjyqësore të dënimit.⁷⁵

Ndërsa si *Mangësi* të këtij dënimi lloharitet se: 1. Gjithmon nuk është e lehtë zbatueshmëria e këtijë dënimi, për arsye të jo barabarësisë dhe gjendjes së rëndë të qytetarëve; 2. Me dënimin në të holla zvoglohet risku i dëmshpërblimit të të dëmtuarit me veprën penale; 3. Jo siguria në fazën e ekzekutimit të dënimit: nëse të dëmtuarit nuk mund ti kompenzohet dëmi, ajo për të paraqet ofendim ndërsa zëvendësimi me burgë paraqet ofendim për kryesin. Gjykata në këto raste duhet të gjejë zgjidhje që të arihet qëllimi i dënimit pa e privuar nga liria dëmtuesin; 4. Pasiguria në ekzekutimin e dënimit në të holla, mund ta kthej sanksionin e krtikuar me privim nga liria; 5. Dënimi me të holla merret me më pak seriozitet se dënimi me burg; 6. Dënimin me të holla mund ta paguaj personi i tret i interesuar.⁷⁶

2.5.1. Zhvillimi i dënimit me të holla në sistemin e sanksioneve

Në zhvillimin historik të dënimit, dënimi me gjobë është më i vjetër se dënimi i privimit nga lira.⁷⁷ Dënimin me të holla apo me gjobë e njohin të gjitha legjislacionet penale të shteteve bashkëkohore, në mesin e dënimeve kryesore për nga pesha, dënimi me të holla në sistemin tonë ndëshkimor është lloji më i lehtë i dënimit.⁷⁸ Dënimi me të holla apo me gjobë, gjithashtu rrjedh nga kompozicioni i kohës së reagimit privat, është ndër dënimet më të hershme dhe

⁷⁵ Stefan Buxhakoski: Kazneno Pravo, opsht del – Ohër, 2014, fq.290-291

⁷⁶ Stefan Buxhakoski: Kazneno Pravo, opsht del – Ohër, 2014, fq.291

⁷⁷ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli: E drejta Penale – pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.261

⁷⁸ Ismet Salihu: E drejta penale, pjesa e përgjithshme – Prishtinë, 2012, fq.445

esenca e tij qëndron në pagimin e një shume të hollash që e cakton organi kompetent i shtetit, si p.sh. gjykata apo ndonjë organë tjetër.⁷⁹

Sanksioni i dënimit me të holla apo siç njihet edhe më parë si gjoba është një ndër saksionet më të vjetra penale, e cila është paraqitur si rezultat ku kryrsi i veprës ia kompezon të dëmtuarit me një shumë të hollash si kompezim për dëmin e shkaktuar dhe poashtu ndalimin për hakmarje. Në zhvillimin historik të dënimeve ky sanksion njihet si sanksion më i vjetër se sanksioni i të privuarit nga liria, në fillim për pengimin e hakmarjes, kompezimin dhe pagimin e dëmit të shkaktuar nga vepra e kryer, ku në shoqërinë e hershme ka qenë sanksion kryesor për shumë vepra penale. Denimi me të holla (gjoba) në të drejtën romake ka qenë dënim kryesor edhe për veprat më të rënda penale, dikur vonë ka shekulli i gjashtë e drejta Gjermane për herë të parë bën ndarjen e një pjese të gjobës ose e ndan në dy gjoba, një për të dëmtuarin dhe një për shtetin. Kohrave të fundit sistemet bashkëkohore të së drejtës penale kanë filluar që dënimin me të holla ta kthejnë si alternative kryesore të dënimit me burg.⁸⁰

E drejta bashkëkohore penale kthehet kah dënimi me gjobë si një prej alternativave kryesore të dënimit me burgim, por është pikëpyetje nëse ky kthim i tillë mund të ketë sukses, dhe nëse njëkohësisht nuk kthehet në funksionin e dyfishtë të dënimit me gjobë; plotësimin e karakterit publiko-juridik të dënimit edhe në interes të të dëmtuarit.⁸¹ Gjithashtu edhe une si autore e këtij punimi e ndaj mendimin se kohrave të fundit shumica e shteteve dënimit me gjobë, për shumicën e veprave penale i japin rëndësi primare, për arsye se me zbatimin e këtij sanksioni më së miri kthehet funksioni i dyfishtë i dënimit (më së miri përmbushet karakteri publik dhe karakteri privat).

2.5.2. Nocioni i dënimit me të holla (gjobë)

Dënimi me gjobë është dënim në pasuri, që përbëhet në imponimin e të dënuarit me obligim penal juridik për të paguar shumë të hollash shtetit për veprën e kryer penale. Si dënim publiko – juridik ai nënkupton pagimin e shumës së të hollave shtetit dhe jo si obligim civil i kryesit kundër shtetit. Poashtu dënimi me gjobë gjithëmon caktohet në shumë të caktuar të hollash dhe nuk mund të përcaktohet në disa vlera të tjera që nuk paraqesin të holla, siç është

⁷⁹ Ragip Halili: Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale – Prishtinë, 2014, fq.93

⁸⁰ Vlado Kambovski: E drejta penale, Pjesa e përgjithshme – Shkup, 2007, fq.512

⁸¹ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli: E drejta Penale – pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.261-262

pagesa në letra me vlerë, sende të shtrejta ose tërheqe të pasurisë. Dënimi me gjobë ka efekt të dyfishtë, ku nga njëra anë zvoglon pasurin e kryerësit, e nga ana tjetër zvogëlimi i këtillë i pasurisë duhet të ketë edhe pasoja më afatgjate në zvogëlimin e mundësisë së kryerësit për harxhime dhe për plotsimin e nevojave të tij.⁸²

Dënimi me të holla përcaktohet në pagesën e një shume të caktuar parash nga ana e kryerësit të veprës penale në dobi të shtetit, si dënim për veprën e kryer. Do të thotë, se shqiptimi i dënimit në të holla paraqet obligim për pagesë ndaj shtetit, e jo ndaj të dëmtuarit, dhe kërkesa pasuore përmbushet me kthimin e sendeve ose me konfiskimin e pasurisë së krijuar nga vepra dhe kompenzimin e dëmit.⁸³

Dënimi me gjobë është dënim personal, mirëpo nuk e përjashton obligimi që e njejta të paguhet apo të plotsohet me përvetsimin e mjeteve të përbashkta ose me mjete të huaja. Për shkak të karakterit të tij personal dhe juridiko-publik, obligimi për pagesën e dënimit shuhet me vdekjen e të dënuarit. Sa i përket rëndësisë kriminale-politike të dënimit me gjobë, ai bën pjesë në sistemin e dënimeve më të buta në krahasim me dënimin me burg, dhe poashtu shqiptohet për dënime më të lehta.

Si zëvendësim për dënimin me burg, posaçërisht atë afatshkurtë, dënimi me gjobë ka disa përparësi! Padyshim qëllimi preventiv-special dhe preventiv-gjeneral i dënimit, e sidomos kur bëhet fjalë për shkelësit primarë, mund të realizohet me dënim me gjobë i baraspeshuar me rëndësinë e veprës.⁸⁴ Me zbatimin e këtij dënimi, largohen efektet negative të burgut: infektimet kriminale në burg, ndërprerja e punës dhe problemet e mëvonshme në riintegrimin e të dënuarit, etj. Për më tepër, për disa kategori të caktuar të kryerësve për të cilët nevojiten masa të nevojshme të trajtimit ose shërimit, dënimi me gjobë ka veprim të dobët preventiv. Poashtu kritikohet se është sanksion tipik retributiv dhe nuk ka bazë etike, pasi që shteti përfiton për llogari të krimit.⁸⁵

⁸² Vlado Kambovski: E drejta penale, Pjesa e përgjithshme – Shkup, 2007, fq.512

⁸³ Stefan Buxhakoski: Kazneno Pravo, opsht del – Ohër, 2014, fq.289

⁸⁴ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli: E drejta Penale – pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.263

⁸⁵ Po aty, fq.263

2.5.3. Sistemi i gjobës ditore

Me qëllim të shmangies së dobësive themelore të dënimit me gjobë, që në mënyrë të pabarabartë t'i godasë kryerësit e veprave penale në varshmëri nga gjendja pasurore e tyre, kështu legjislacionet evropiane e kanë braktisur sistemin e përcaktimit fiks të dënimit me gjobë dhe me të madhe e kanë pranuar modelin skandinak të dënimit me gjobë i njohur si sistemi i gjobës ditore.⁸⁶ Me rastin e matjes së dënimit me gjobë në mënyrë të posaçme duhet të meret parasysh gjendja e tërësishme materiale e kryerësit, në mënyrë që personat me gjendje materiale të ndryshme, peshën e këtij lloji të dënimit ta ndiejnë njësoj, për këtë arsyë disa shtete (p.sh: Suedia, Austria, Gjermania, Sllovenia) njohin sistem të tillë ndëshkimor, ku lartësia e dënimit me gjobë caktohet varësisht prej mëditjes, sa fiton për një dit pune.⁸⁷

Është paraqitur si rezultat i shmangies së dobësive themelore të dënimit me gjobë duke u paraqitur si i pabarabartë dhe duke e braktisur sistemin e përcaktimit fiks të dënimit me gjobë. Sistemi i gjobës ditore për her të parë u paraqit në Suedi. Sistemi i gjobave ditore përbëhet në përcaktimin e numrit të gjobave ditore sipas shkallës së padrejtsisë dhe fajit të kryerit, ku madhësia e gjobës ditore përcaktohet sipas rrethanave personale dhe pasurore të kryerit. Ligji përcakton numrin më të madh dhe më të vogël të gjobave në ditë, si dhe gjobën ditore.⁸⁸

2.5.4. Regjimi ligjor i dënimit me gjobë, shqiptim dhe matja ligjore e gjobës ditore

Dënimi me gjobë mund të shqiptohet si dënim kryesorë dhe si dënim sekondar së bashku me dënimin me burg. Si dënim kryesorë për here të parë është paraparë në kodin penal të RMV-së pas reformimit të tij në vitin 2004 dhe është pranuar sistemi i gjobës ditore. Dënimi me të holla rregullohet me neni 38 të kodit penal, ku thuhet se:

- 1) Dënimi me para shqiptohet në gjoba ditore, gjatë së cilës numri i gjobave ditore nuk mund të jetë më pak se pesë, as më shumë se 360 gjoba ditore;
- 2) Gjykata e llogarit numrin e gjobave ditore sipas rregullave të përgjithshme për llogaritjen e dënimit;

⁸⁶ Po aty, fq.263-264

⁸⁷ Ismet Salihu: E drejta penale, pjesa e përgjithshme – Prishtinë, 2012, fq.446

⁸⁸ Vlado Kambovski: E drejta penale, Pjesa e përgjithshme – Shkup, 2007, fq.514

3) Lartësinë e gjobave ditore gjykata e përcakton duke i pasur parasysh rrethanat pronësore personale të kryerësit, duke u nisur nga rregulli i të hyrave të pastra ditore që kryerësi i realizon ose mund t'i realizojë, si dhe nga obligimet tjera dhe ato familjare të kryerësit dhe gjendjen e tij pronësore gjatë kohës së marrjes së vendimit gjyqësor. Vlera më e vogël e gjobës ditore është një euro në kundërvlerë në denarë, dhe më e madhja 5.000 euro në kundërvlerë në denarë;

4) Vendimi gjyqësor e përfshin shumën e dënimit me para që fitohet me shumëzimin e numrit të gjobave ditore me vlerën e përcaktuar të gjobës ditore;

5) Nga shkak i përcaktimit të vlerës së gjobës ditore, gjykata mund të kërkojë informim nga bankat, institucionet tjera dhe ato financiare, organet shtetërore dhe personat juridik, të cilët janë të obliguar t'i dërgojnë informatat e kërkuara dhe nuk mund të thirren në mbrojtjen e sekretit afarist dhe sekretit tjetër;

6) Kur dënimi me para shqiptohet si dënim plotësues përkrah dënimit me burg, gjykata e përcakton në shumë të parave, pa zbatimin e dispozitave nga paragrafët (1) deri në (5). Dënimi me para si dënim plotësues nuk mund të jetë më i vogël se 20 euro në kundërvlerë në denarë, e as më i madh se 5.000 euro në kundërvlerë në denarë.

Shqiptimi i dënimit me të holla është operacioni pak i ndërlikuar, që paraqet mbledhjen e të dhënave nga ana e gjykatës për rrethanat personale dhe pasurore të kryerësit. Pastaj gjykata duhet të niset nga të ardhurat e pastërta ditore që kryerësi i realizon ose mund ti realizoj, si dhe nga obligimet familjare dhe obligimet tjera si dhe gjendja e tij pasurore në kohën kur është sjellë aktgjykimi. KPM e përcakton edhe nocionin e të ardhurave ditore të pastërta, ku me të ardhura ditore të pastërta nënkuptojmë rrogën neto ose të ardhura të tjera neto nga kryerja e veprimtarive tjera.⁸⁹

Matja e dënimit me të holla bëhet duke i'u përmbajtur *rregullave të përgjithshme për matjen e dënimit*, në bazë të të cilave gjykata do t'i përcaktojë dënim kryesit të veprës penale brenda kufijve që janë caktuar me ligj për atë veprë, duke pasur parasysh përgjegjësinë penale të kryesit, peshën e veprës dhe qëllimet e dënimit.⁹⁰ Poashtu gjykata duhet t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i vogël ose më i madh (rrethanat lehtësuese dhe rënduese), kurse veçanërisht: shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra, fuqia e rrezikimit ose shkeljes të së mirës së mbrojtur, rrethanat nën të

⁸⁹ Vlado Kambovski: E drejta penale, Pjesa e përgjithshme – Shkup, 2007, fq.515

⁹⁰ Neni 39: Kodi penal i RMV-së, Tekst i konsoliduar – Tetor 2020

cilat është kryer vepra, kontributi i viktimës në kryerjen e veprës, jetesa e mëparshme e kryesit, mundësitë e tij personale dhe sjellja e tij pas veprës penale të kryer, si dhe rrethana tjera që kanë të bëjnë me personalitetin e kryesit.

Gjatë përcaktimit të dënimit gjykata në mënyrë të veçantë do të mbajë llogari për veprimin e përgjithshëm të dënimit dhe pasojat e tij mbi personalitetin e kryerësit dhe nevojat për risocializimin e tij. Kur gjykata ia përcakton dënimin kryerësit për vepër penale të kryer në kthim, në veçanti do të ketë parasysh nëse vepra e mëparshme është e llojit të njëjtë si edhe vepra e re, nëse veprat janë kryer nga të njëjtat motive dhe sa kohë ka kaluar nga dënimi i mëparshëm, respektivisht nga dënim i vuajtur ose i falur.

Gjatë matjes së dënimit, gjykata veçanërisht do të ketë parasysh nëse vepra penale është kryer kundër personit ose grupit të personave ose pronës, drejtpërdrejtë apo tërthorazi, për shkak të përkatësisë së tyre të seksit të caktuar, racës, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, përkatësisë së grupit të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, religjionit ose bindjes fetare, llojeve tjera të bindjeve, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, pengesës mentale ose trupore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, ose në cilëndo bazë tjetër të paraparë me ligj ose marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare. Nëse gjykata nuk e zbaton këtë dispozitën, është e detyruar t'i arsyetojë shkaqet e vendimit të tillë.

Gjatë përcaktimit të dënimit me para, gjykata do ta merr parasysh edhe gjendjen pronësore të kryesit, duke mbajtur llogari për të ardhurat tjera të tij, për pasurinë e tij dhe për obligimet e tij familjare.

Kur dënimi me gjobë, shqiptohet si dënim sekondar së bashku me dënimin me burgim si dënim primar, zbatohet sistemi i shumë fikse të të hollave, si dënimi shqiptohet në shumë që nuk mund të jetë më e ulët se 20 euro dhe as më e madhe se 5000 euro në kundërvlerë në denarë. Gjatë matjes së dënimit, gjykata i merr parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit, posaçërisht gjendjen e pasurisë së kryerësit, të ardhurat tjera të tij, pasurinë e tij dhe obligimet familjare.⁹¹ Edhe pse dënimi me gjobë shqiptohet si dënim primar por mund të shqiptohet edhe si dënim plotësues krahas dënimit me burg, mirëpo sipas mendimit tim dënimi me gjobë, si dënim primar duke pasur parasysh të gjitha elementet për matjen e dënimit për shumicën e veprave penale është dënim më ekuivalent për shoqërinë.

⁹¹ Vllado Kambovski, Ismail Zejneli: E drejta Penale – pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.265

2.5.5. Arkëtimi dhe ndërrimi i gjobës ditore (Paguesa dhe zëvendësimi i dënimit me gjobë)

Gjykata në vendimin gjyqësor e përcakton afatin për pagimin e dënimit me të holla, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë, e as më i gjatë se tre muaj, por në rastet e arsyeshme gjykata mund të lejojë i dënuari ta paguajë dënimin me para edhe në këste, me atë që afati i pagesës të mos jetë më i gjatë se dy vjet. Nëse kryerësi është i huaj, gjykata do të vendosë që dënimi në para të paguhet pa shtyrje, ose në mënyrë tjetër të sigurohet pagesa e saj.

Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me para në afatin e caktuar, gjykata mund të përcaktojë afat të ri ose nëse vlerëson se i dënuari nuk dëshiron ta paguaj, atëherë gjykata të urdhërojë pagimin e tij me detyrim sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Nëse dhënia e afatit të ri i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tre muaj ose zbatimi me detyrim ngelin pa sukses, gjykata do ta zbatojë vendimin që për secilën gjobë ditore do të përcaktojë një ditë burg ose, kur dënimi në para është shqiptuar si dënim plotësues, për secilat 20 euro të filluara në kundërvlerë në denarë do të përcaktojë një ditë burg, me atë që burgu nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj.

Nëse i dënuari paguan vetëm një pjesë nga dënimi me para, pjesa e ngelur në mënyrë proporcionale do të shëndërrohet në burg, e nëse ai e paguan pjesën e ngelur të dënimit me para, zbatimi i burgut do të ndërpritet. Në sistemet bashkohore penalo-juridike, ekzistojnë zgjidhje të ndryshme në raport me problemet që dalin në rast kur i dënuari nuk mund ose nuk don që ta paguaj dënimin me gjobë. Në qoftë se i dënuari nuk e paguan vullnetarisht dënimin me gjobë në afatin e caktuar, gjykata mund ta vazhdoj atë afat nëse gjen se për të ekzistojnë arsye.

Kapitulli i III

3. Aspektet krahasimore të gjobës si sanksion kundërvajtës dhe gjobës si sanksion penal

Sa i perket gjobës si sanksion kundërvajtës dhe si sanksion penal, për të cilën kemi folur në dy kapitujt pararendës, në këtë kapitull do të mundohemi në pika të shkurta ti cekim pikat afruse dhe larguese të të njejtit sanksion, por edhe që dallojn shumë ndërmjet veti mvarësisht nga ligjet që e normojnë, si në procedurë për shqiptim, ashtu edhe në matje dhe arkëtim.

3.1. Ngjajshmëria si masë shtërnguse e tyre dhe mënyra e normimit të sanksionit

- Gjopa qoftë si sanksion kundërvajtës, qoftë si sanksion penal konsiderohet si masë shtrënguse ndaj kryerësve të veprave penale ose kundërvajtëse që në të ardhmen mos të kryjnë vepra të ndaluara sipas normave pozitive.
- Aspekti preventiv ka për qëllim që duke zbatuar sanksionin (gjobën) e caktuar të ndikohet në uljen e kriminalitetit në përgjithsi, si atij kundërvajtës ashtu edhe atij penal.
- Që te shqiptohet gjopa si sanksion kundërvajtës apo penal duhet të jet e paraparë dhe e përcaktuar me ligj.
- Duhet të zhvillohet procedurë e paraparë me ligj procedural të përgjithshëm apo të veçant.
- U shqiptohet vetëm personave që shpallen fajtor (personalizimi).
- Lidhur me normimin e gjobës si sanksion kundërvajtës ose penal në shtjellimin e kapitujve pararendës parashifet edhe me ligj, si: kodi penal, ligji për kundërvajtje dhe ligje të tjera materiale.

3.2. Dallimet në mes organeve që shqiptojnë, procedura deri te shqiptimi, si dhe pesha e sanksionit

Në viti 2006 me ndryshimet e fundit të kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, më konkretish me amandamentin 20 bëhet plotësim ndryshimi i nenit 13 të kushtetutës, si në vijim “Për kundërvajtjet e përcaktuara me ligj, sanksione mund të shqiptojë organi i administratës shtetërore ose organizatat dhe organet tjera që kryejnë autorizime publike. Kundër vendimeve përfundimtare për kundërvajtje, garantohet mbrojtja gjyqësore në bazë të kushteve dhe procedurës së përcaktuar me ligj”⁹². Që domethënë se lejohet edhe organet shtetërore administrative të mund të shqiptojnë sanksione kundërvajtëse, edhe kur ato janë të parapara shprehimisht me ligj, për arsye se më parë vetëm gjykata mund të shqiptonte sanksione kundërvajtëse. E për herë të parë parashihet hibridizimi i normave material dhe atyre procedurale në zhvillimin e procedurës kundërvajtëse.

Me ligjin për kundërvajtje rregullohen kushtet e përgjithshme për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve të kundërvajtës, kushtet e përgjithshme për përcaktimin e përgjegjësisë së kundërvajtjes, për shqiptimin dhe zbatimin e sanksioneve të kundërvajtjes, procedurat e përshpejtuara të kundërvajtjes dhe përcaktohet procedura e kundërvajtjes që e mbajnë gjykatat, përkatësisht organet e kundërvajtjes.

- Zbatimi i dispozitave të Kodit P., Ligjit për Procedurë P. dhe ligjeve tjera - Për kundërvajtjen dhe përgjegjësinë e kundërvajtjes në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit penal. Nëse me dispozitat e këtij ligji nuk është përcaktuar ndryshe, gjykatat në procedurën e kundërvajtjes i zbaton dispozitat e Ligjit për procedurë penale që u referohen parimeve themelore: gjuhës, kompetencës së vendit, pasojave nga jokompetenca, konfliktit të kompetencave, përjashtimit, akuzës, mbrojtësit, parashtrësive, procesverbaleve, kërkesës pronësore juridike, miratimit dhe njoftimit të vendimeve, dorëzimit të dokumenteve dhe mjeteve juridike me shkrim të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

- Kompetenca për kundërvajtje - Procedurë për kundërvajtje dhe sanksion për kundërvajtje mund të shqiptojë vetëm gjykata kompetente. Për kundërvajtje të veçanta të përcaktuara me ligj, procedurë për kundërvajtje mund të udhëheqë dhe sanksion për

⁹² Amandamenti 20: Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut 17.11.1991 – Tekst i konsoliduar Dhjetor 2020

kundërvajtje mund të shqiptojë organi për kundërvajtje. Kundër vendimit përfundimtar për kundërvajtje garantohet mbrojtje gjyqësore. Të gjitha organet shtetërore dhe bartësit e autorizimeve publike kanë për detyrë që gjykatës dhe organeve nga paragrafi i këtij neni, t'u japin ndihmë të nevojshme falas dhe të dhëna të nevojshme për përcaktimin e fakteve në lidhje me procedurën dhe zbatimin e sanksioneve.

- Kompetenca e organit për kundërvajtje - Organi për kundërvajtje udhëheq procedurë për kundërvajtje kur me ligj është përcaktuar kompetenca ekskluzive për veprimin e tij. Për udhëheqjen e procedurës për kundërvajtje kundër personit juridik, kompetent është organi për kundërvajtje ku gjendet selia e personit juridic, përkatësisht përfaqësia e personit të huaj juridik, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe.

- Konflikti i kompetencës – Kompetenca e gjykatave është e përcaktuar me ligj dhe secila gjykatë duhet të veprojë në suaza e kompetencës së vetë, kur vjen deri te konflikti i kompetencës qoftë ai pozitiv apo negativ ligjëvënsi ka parapar zgjedhjen e konfliktit (neni32), ku për zgjedhjen e konfliktit të kompetencës kompetente është gjykata drejtëpërdrejt më e lartë e cila i mbulon gjykata në konflikt.⁹³

Për konflikt kompetence ndërmjet gjykatave dhe organeve për kundërvajtje vendos Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë.⁹⁴

- Procedurat e përshpejtuara- Qëllimi i procedurave të përshpejtuara është arritja e pëlqimit të kryerësit të kundërvajtjes dhe organeve kompetente të autorizuara për ngritjen e procedurës për kundërvajtje për mënjanimin e pasojave të dëmshme të kundërvajtjes së kryer dhe për ndalimin e kryerjes së sërishme të kundërvajtjeve dhe për shmangie të udhëheqjes së procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente, përkatësisht organit për kundërvajtje. Organet shtetërore kompetente të autorizuara për ngritje të procedurës për kundërvajtje, janë të detyruara që t'i propozojnë kryerësit të kundërvajtjes një prej procedurave të përshpejtuara, para se të parashtrajnë kërkesën për ngritje të procedurës për kundërvajtje, vetëm nëse është e përcaktuar me ligj. Gjykata, përkatësisht organi për kundërvajtje me detyrë zyrtare kujdeset atëherë kur është zbatuar njëra prej procedurave të përshpejtuara. Nëse nuk janë përmbushur kushtet, gjykata përkatësisht organi për kundërvajtje do ta kthejë kërkesën e organit që të zbatohet njërën prej procedurave të përshpejtuara.

⁹³ Ejup Sahiti, Ismail Zejneli: E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonis, Shkup, 2017

⁹⁴Neni 50: Ligji për kundërvajtje, Gazeta zyrtare e RMV, nr.96/2019

- Llojet e procedurave të përshpejtuara -

Ekzistojnë dy lloje të procedurave të përshpejtuara për barazim:

1. Procedura mandatore me lëshimin e urdhërpagesës mandatore
2. Procedura për lëshimin e urdhërpagesës për kundërvajtje

Ekzistojnë dy lloje të procedurave të përshpejtuara për kontraktim:

1. Procedura për kontraktim me persona fizikë dhe juridikë
2. Procedura për kontraktim me fëmijë.⁹⁵

3.2.1. Procedura kundërvajtëse para organeve për kundërvajtje

Autorizimi për udhëheqjen e procedurës - Procedurën para organit për kundërvajtje e udhëheq Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje të përcaktuar me ligj ose rregull tjetër. Anëtarët e Komisionit janë nëpunës të autorizuar me shkallë dhe lloj përkatës të përgatitjes profesionale dhe përvojë të nevojshme pune të përcaktuara me ligj, nga të cilët së paku një prej anëtarëve është jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës.

Dorëzues i kërkesës - Procedura për kundërvajtje udhëhiqet me kërkesë nga organi i autorizuar ose i dëmtuari (në tekstin e mëtejshëm: dorëzuesi i kërkesës).

Ngritja e procedurës për kundërvajtje - Organi për kundërvajtje ngrit procedurë për kundërvajtje me detyrë zyrtare, me kërkesë të personit zyrtar ose me kërkesë të organit të autorizuar dhe të dëmtuarit. Kërkesa i parashtrohet organit kompetent për kundërvajtje. Nëse kërkesa i është parashtruar organit tjetër, ai menjëherë do t'ia lëshojë organit kompetent për kundërvajtje dhe për këtë do ta njoftojë parashtruesin e kërkesës. Nëse gjatë procedurës organi për kundërvajtje konstaton se nuk është kompetent real për kundërvajtje, përkatësisht është në kompetencë të gjykatës, me aktvendim do të shpallet si jokompetent dhe kërkesën për ngritje të procedurës për kundërvajtje do t'ia dërgojë gjykatës kompetente.

Procedura para organit për kundërvajtje - Organi për kundërvajtje me detyrë zyrtare pa prolongim i merr dëshmitë dhe e konstaton gjendjen faktike të nevojshme për vendimmarrje për kundërvajtje. Organi për kundërvajtje para miratimit të vendimit për kundërvajtje,

⁹⁵ Neni 44: Ligji për kundërvajtje, Gazeta zyrtare e RMV, nr.96/2019

detyrimisht do ta njoftojë kryerësin për kundërvajtjen që i ngarkohet dhe e këshillon se në afat prej tri ditësh ka të drejtë që të prononcohet për faktet dhe dëshmitë. Me përjashtim, për kundërvajtje të caktuara me ligj mund të përcaktohet edhe afat më i gjatë për prononcim, nëse me Direktivat evropiane janë paraparë afate më të gjata për prononcim. Organi për kundërvajtje mund ta ftojë kryerësin e kundërvajtjes që të prononcohet gojarisht për faktet dhe dëshmitë. Nëse kryerësi i kundërvajtjes e pranon kryerjen e kundërvajtjes dhe pohimi është i qartë dhe i plotë, organit për kundërvajtje nuk i nevojitet të mbledhë edhe dëshmi tjera.⁹⁶

Procedura urgjente - Për kundërvajtje vendoset në procedurë urgjente, përveç në rastet kur me ligj është përcaktuar ndryshe. Procedura urgjente nuk lejohet: nëse me kundërvajtjen ka ndodhur lëndim trupor, nëse me kundërvajtje përveç gjobës është përcaktuar edhe sanksion ndalim i drejtimit të automjetit, nëse nevojitet të vendoset për kërkesa pronësore juridike dhe në raste tjera të përcaktuara me ligj.

Procedura e shkurtuar - Organi për kundërvajtje udhëheq procedurë të shkurtuar kur: në kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje përmbahen të gjitha faktet dhe dëshmitë në bazë të të cilave mund të vendoset pa prezencë të kryerësit të kundërvajtjes, kërkesa për ngritje të procedurës bazohet në dokumente publike të lëshuara nga organet shtetërore kompetente dhe kur kryerësi gjatë kryerjes së kundërvajtjes është ndjekur nga personi i autorizuar zyrtar. Në procedurë të shkurtuar vendoset pa marrje në pyetje kryerësin kur ai ftohet me rregull e nuk paraqitet dhe nuk dorëzon dëshmi për pengesën e arsyeshme për t'u paraqitur para organit për kundërvajtje.

Procedura për ankesë kundër vendimeve të organeve për kundërvajtje - Kundër aktvendimit për kundërvajtje që e ka miratuar organi kundërvajtës mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, përmes organit kontraktues në Komisionin shtetëror për vendim marrje në shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës kundërvajtëse, të themeluar me ligj të veçantë. Ankesë mund të paraqesë personi (fizik ose juridik) të cilit i është shqiptuar sanksion kundërvajtës, përfaqësuesi i tij ligjor, përkatësisht mbrojtësi, i dëmtuari ose përfaqësuesi i tij, pronari i sendeve të konfiskuara në procedurën kundërvajtëse dhe parashtruesi i kërkesës për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.⁹⁷ Nëse organi kundërvajtës që e ka miratuar aktvendimin konstaton që ankesa ka bazë, dhe nuk është e nevojshme të zbatohet procedurë e re, ai mund të vendos ndryshe dhe

⁹⁶ Neni 60: Ligji për kundërvajtje, Gazeta zyrtare e RMV, nr.96/2019

⁹⁷ Neni 68: Ligji për kundërvajtje, Gazeta zyrtare e RMV, nr.96/2019

me vendim të ri ta zëvendësojë vendimin që atakohet me ankesën. Ankesa e shtynë realizimin e aktvendimit, përveç rastit kur ankesa është e parashtruar nga person i huaj.

E drejta e ngritjes së kontestit administrativ - Kundër aktvendimit për kundërvajtje mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit. Padi mund të parashtrorë personi (fizik ose juridik) të cilit i është shqiptuar sanksion kundërvajtjes, përfaqësuesi i tij ligjor, mbrojtësi dhe pronari i sendeve të konfiskuara në procedurë kundërvajtëse.

Nëse organi kundërvajtës që e ka miratuar aktvendimin, në momentin që kur do t'i dorëzohet padi ndaj përgjigjes konstaton se e njëjta është e bazuar, kurse nuk është e nevojshme të zbatohet procedurë e re, poashtu mund të vendosë ndryshe dhe me vendim të ri ta zëvendësojë vendimin që rrëzohet me padinë. Organi kundërvajtës menjëherë e informon gjykatën kompetente për vendimmarrje për kontest administrativ, i cili me aktvendim e ndërpret procedurën. Padia e shtyn zbatimin e aktvendimit.⁹⁸

Aktvendimi i Komisionit Shtetëror mund të atakohet: nëse ligji është zbatuar në mënyrë jo të drejtë, nëse akti është miratuar nga organi jokompetent dhe nëse në procedurën e cila i ka paraprirë aktit nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, ose nëse nga faktet e konstatuara është nxjerrë konkluzion i padrejtë në lidhje me gjendjen faktike.

Eshtë 4 shkallësh - Shakalla e parë është organi që kundër ti vendos komisioni shtetëror, pastaj kundër këti vendimi ka të drejt në padi për contest administrativ në gjykatën administrative dhe kundër këti vendimi vendos gjykata e latrë administrative.

Zakonisht organet kundravajtse vendosin për procedura të cilat janë më të shkurtëra dhe të cilat kanë prova të drejtpërdrejta si : radarët, fotografimet, etj .

3.2.2. Procedura kundërvajtëse para gjykatës

Kompetenca reale - Procedurën për kundërvajtje në shkallë të parë e udhëheq gjykatësi individ në gjykatën themelore, ndërsa procedurën e mjeteve juridike këshilli nga tre gjykatës.

⁹⁸ Neni 70: Ligji për kundërvajtje, Gazeta zyrtare e RMV, nr.96/2019

Ngritja e procedurës për kundërvajtje - Nëse gjykata nuk miraton aktvendim për hedhje poshtë të kërkesës, gjykata është e obliguar që të caktojë seancë gjyqësore dhe për këtë ta informojë të akuzuarin. Gjykata së bashku me thirrjen për marrje në pyetje do t'i dorëzojë të akuzuarit kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje së bashku me dëshmitë me shkrim.

Llojet e masave - Masat që mund të merren ndaj të akuzuarit për sigurimi e pranisë dhe për udhëheqjen e procedurës për kundërvajtje janë: thirrja, arresti, mbajtja, garancia dhe heqja e përkohshme e dokumentit të udhëtimit për të huaj dhe mbajtja e të huajit në qendrën e pranimit.

Procedura e shkurtuar - Procedura e shkurtuar mbahet kur: në kërkesën për ngritjen e procedurës për kundërvajtje përmbahen të gjitha faktet dhe dëshmitë në bazë të të cilave mund të vendoset pa praninë e palës, kur kërkesa për ngritjen e procedurës bazohet në dokumentet publike të lëshuara nga organet kompetente shtetërore dhe kur kryerësi është hasur gjatë kryerjes së kundërvajtjes nga personi i autorizuar zyrtar. Në procedurë të shkurtuar gjykata vendos pa marrje në pyetje të akuzuarit, kur ai është ftuar me rregull e nuk paraqitet dhe nuk dorëzon dëshmi për pengimin e arsyeshëm që të paraqitet në gjykatë.

Mbledhja e përhershme e gjyqit - Për shkak të shpejtësisë së procedurës gjykata siguron punë të vazhdueshme gjatë 24 orëve. Me orarin e punës së gjykatës përcaktohet gjykatës kujdestar dhe punëtor gjyqësor gjatë gjithë ditës, ditë jo pune dhe ditë feste.⁹⁹

Procedura urgjente - Gjykata është e obliguar të ngritë procedurë menjëherë pas pranimit të kërkesës për ngritjen e procedurës e më së gjati në afat prej tri ditësh. Kërkesa para gjykatës së shkallës së parë doemos duhet të mbarohet në afat prej tre muajsh nga dita e parashtrimit të kërkesës për ngritjen e procedurës kundërvajtëse. Kur i akuzuari është i huaj, gjykata në procedurë urgjente vendos në afat sa më të shkurtër të mundshëm, por jo më të gjatë se tri ditë. Ankesa e parashtruar nga i huaji nuk e prolongon zbatimin e vendimit.¹⁰⁰

Llojet e vendimeve - Procedura e kundërvajtjes përfundon me miratimin e aktgjykimit apo aktvendimit, pra edhe këtu shqiptohen të dy llojet e vendimeve.¹⁰¹

⁹⁹ Neni 106: Ligji për kundërvajtje, 17.05.2019 - Republika e Maqedonisë së Veriut

¹⁰⁰ Neni 107: Ligji për kundërvajtje, 17.05.2019 - Republika e Maqedonisë së Veriut

¹⁰¹ Neni 112: Ligji për kundërvajtje, 17.05.2019 - Republika e Maqedonisë së Veriut

Llojet e mjeteve juridike - Kundër aktgjykimit dhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë te gjykata e shkallës së dytë. Në procedurën kundërvajtëse të mbaruar me aktgjykim mund të shfrytëzohen mjete juridike të jashtëzakonshme: kërkesa për rishqyrtim të procedurës kundërvajtëse dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.¹⁰²

Për një kundërvajtje të parapara sipas ligjit për siguri në komunikacion, mund të zhvillohen procedura sipas normave procedurale të parapara me ligje të ndryshme.

Lidhur me kundërvajtjen që parashihet tejkalimi i shpejtësisë, e kufizuar me shenjë të komunikacionit. Personi zyrtarë posa e konstaton se personi X ka kryer kundërvajtje, tejkalim të shpejtësisë mbi 30 km/h, ai do ti ofroj procesverbalin se ka kryer kundërvajtjen, ku parashihet vepra kundërvajtëse, elementet e të cilës shënohen të dhënat personale të kryesit, si dhe vendin, koha, mënyra, etj, dhe do ti ofroj urdhërpagesë që në afat prej 8 ditëve të bëj pagesën e gjobës, (ku nëse për një kundërvajtje gjoba është e parapara 300 euro, nëse e paguan në këtë afat gjobën do ta paguaj në gjysëm dmth 150 euro).¹⁰³ Nëse në afatin e parapara nuk paguhet gjoba sipas urdhërpagesës kundërvajtëse, personi zyrtarë, në afat prej 30 ditëve do të ngre fletëparaqitje kundërvajtëse deri te organi për kundërvajtje pranë ministrisë së punëve të mbrendëshme, ku ky organ procedurën kundërvajtëse do ta udhëheq në bazë të normave të parapara në ligjin për kundërvajtje për organin kundërvajtës, dhe ligjit për procedurë të përgjithshme administrative. Për kundërvajtjen e lartpërmendur, sipas të të njejtë ligj parashifet edhe masa e siguris (marja e lejes për vozitje, në afat të caktuar), ku personi zyrtarë detyrohet që fletëparaqitjen pamar parasysh se kundërvajtësi a e ka pagujtur gjobën ose jo, fletëparaqitjen tja dorzoj gjykatës themelore, për shqiptimin e sanksionit që parasheh masat e siguris. Për masën e siguris, gjykata themelore procedurën do ta zhvilloj në bazë të normave të ligjit për kundërvajtje dhe ligjit për procedurë penale.

Nga e gjitha ajo që kemi cekur deri tani konkludojmë se për të njejtën kundërvajtje përdoren norma procedurale të ndryshme, mvarësisht nga ajo se kush vendos për gjobën e kush për masën e sigurisë. Nga ky hibridizim gjithashtu ndryshim të madh ka edhe sa i përket mjeteve juridike që mund të përdor pala kundër vendimit për kundërvajtje.

Për vendimin e masës siguroese marja e lejes për vozitje, pala ka të drejtë kundër vendimit të shkallës së parë të ankimoj deri te gjykata e apelit, dmth këtu vjen në shprehje

¹⁰² Neni 124: Ligji për kundërvajtje, 17.05.2019 - Republika e Maqedonisë së Veriut

¹⁰³ Neni 38: Ligji për siguri në komunikacionin rrugor, Gazeta zyrtare nr.54/2007

dyskallshmëria. Ndërsa sa i përket sanksionit të gjobës, kundërvajtësit i mundësohet të zhvilloj një procedure 4 shkallëshe (organet). Përafërsisht normim të njejtë parashef edhe ligji i ri për sigurin në komunikacion rrugor i sjellur në fuqi në vitin 2015.

Si pikë tjetër larguse apo ndryshe thënë si pika më e rëndësishme në mes gjobës si sanksion penal ose si sanksion kundërvajtës është pesha e tyre, ku kemi cekur edhe me lartë se edhe pse kanë shumë ngjajshmëri në mes veti, por pesha e tyre bën që ato të dallojnë në mes veti.

Kapitulli i IV

4. Pyetsori dhe rezultatet e fituara nga anketat dhe intervistat e përpiluara


Duke u nisur nga ajo që punimi lidhet me sanksionet të cilët zbatohen ndaj subjekteve qofshin ato persona juridik apo fizik, pa dyshim që efekti i tyre drejtpërsëdrejti ndikon mbi individët të cilët janë pjesë e këtij procesi. Për të pasqyruar me mendimet dhe përvojat e qytetarëve këtij punimi i kemi bashkangjitur edhe rezultatet e fituara me metodën e anketimit të cilën e kemi realizuar nëpërmjet dy pyetësorëve të ndryshëm, ku kemi bërë kategorizim në bazë të njohurive për temën dhe i kemi ndarë në dy grupe, ato që posedojnë njohuri profesionale në lidhje me tezën (Juristët), dhe ato që skanë njohuri profesionale në lidhje me tezën (qytetarët laik).

Në grupin e personave profesional kemi përfshirë personat të cilët kanë njohuri të drejtëpërdrejta rreth çështjeve juridike si rezultat i arsimimit, profesionit dhe punës së tyre që ato e ushtrojnë në përditshmëri, ndërsa në grupin e dytë janë personat laik të cilët janë qytetarë të moshave dhe profesioneve të ndryshme të cilët nuk kanë ndonjë lidhje konkrete me çështjet juridike.

Fillimisht do të elaborohen të dhëna e fituar nga anketimi i realizuar me personat që kanë njohuri profesionale (jurist), e pastaj do të elaborohen të dhënat e fituara nga anketimi i realizuar me qytetarët e thjeshtë të cilët nuk posedojnë njohuri profesionale për tezën.


4.1. Të dhënat nga anketa e realizuar me personat të cilët posedojnë njohuri profesionale në lidhje me këtë tematikë (Grupi i Juristëve):

Grafikoni 1 - A mendoni se gjobat e parapara sipas ligjit për kundërvajte dhe ligjeve tjera materiale, janë në përputhje me standardet ekonomike të RMV-së?




Në pyetjen e parë, a mendoni se gjobat e parapara sipas ligjit për kundërvajte dhe ligjeve tjera materiale, janë në përputhje me standardet ekonomike të RM-së, 16% e të anketuarve mendojnë që dënimet janë në përputhje me standardet ekonomike të RMV-së, 26% e të anketuarve mendojnë që deri diku janë në përputhje me standardet ekonomike të RMV-së, ndërsa 58% e të anketuarve mendojnë që gjobat aspak nuk janë në përputhje me standardet ekonomike të RMV-së.

Grafikoni 2 - Dënimi në të holla (gjoba) i shqiptuar si sanksion penal, a e tejkalon peshën e veprës së inkriminuar?



Në pyetjen e dytë, Dënimi në të holla (gjoba) i shqiptuar si sanksion penal, a e tejkalon peshën e veprës së inkriminuar, 22% e të anketuarve janë përgjigjur po, 31% e të anketuarve janë përgjigjur jo, ndërsa 47% e të anketuarve janë përgjigjur deri diku.

Grafikoni 3 - Gjobat e shqiptuara si sanksion kundërvajtës, a e tejkalojnë peshën e veprës së inkriminuar?




Në pyetjen e tretë, Gjobat e shqiptuara si sanksion kundërvajtës, a e tejkalojnë peshën e veprës së inkriminuar, 37% e të anketuarve janë përgjigjur po, 36% e të anketuarve janë përgjigjur jo, ndërsa 27% e të anketuarve janë përgjigjur deri diku.

- **Cilat lloje të veprave kundërvajtëse paraqiten si më të shpeshta?**

Janë përgjigjur me këto lloje të veprave kundërvajtëse :


- Prishja e rendit publik;
- Shkeljet në komunikacion , ku si më të shpeshta paraqiten: 1.Vozitje në orë të vona(pas orës 22) nga vozitësit fillestar, 2.Kalimi në semafor të kuq, 3.Vozitje në gjendje të alkoolizuar, 4.Mosrespektimi i rregullave në komunikacion, 5.Vozitje me shpejtësi përtej normës së lejuar;
- Kundërvajtjet kundër personave juridik;
- Kundërvajtjet në ndërmarjet private;
- Kundërvajtjet doganore;
- Kundërvajtjet tatimore;
- Kundërvajtjet në marrëdhëniet e punës;
- Kundërvajtjet bujqësore (pylltari).

Grafikoni 4 - Sipas përvojës që ju keni me palë, a mendoni se të njejtit kanë njohuri për dallimet procedurale të gjobës (si sanksion kundërvajtës) dhe dënimit në të holla (si sanksion penal)?




Në pyetjen e pestë, Sipas përvojës që ju keni me palë, a mendoni se të njejtit kanë njohuri për dallimet procedurale të gjobës (si sanksion kundërvajtës) dhe dënimit në të holla (si sanksion penal), 20% e të anketuarve janë përgjigjur po kanë, 54% e të anketuarve janë përgjigjur deri diku, 26% e të anketuarve janë përgjigjur aspak.

Grafikoni 5 - Nga përvoja juaj, përveç gjobës si sanksion kundërvajtës, a ka raste ku krahas saj shqiptohen edhe sanksione tjera kundërvajtëse?




Në pyetjen e gjashtë, nga përvoja juaj, përveç gjobës si sanksion kundërvajtës, a ka raste ku krahas saj shqiptohen edhe sanksione tjera kundërvajtëse, 39% e të anketuarve janë përgjigjur shpesh herë, 49% e të anketuarve janë përgjigjur shumë rallë, ndërsa 12% janë përgjigjur thujtse asnjëherë.

Grafikoni 6 - A posedohen mehanizma të mjaftueshme për zbatimin e sanksionit me gjobë?




Në pyetjen e shtatë, a posedohen mehanizma të mjaftueshme për zbatimin e sanksionit me gjobë, 24% e të anketuarve janë përgjigjur po, 32% e të anketuarve janë përgjigjur jo, ndërsa 44% e të anketuarve janë përgjigjur deri diku.

Grafikoni 7 - A mendoni se sanksionet kundërvajtëse (gjobat) duhet të jenë më të ulta?




Në pyetjen e tetë, a mendoni se sanksionet kundërvajtëse (gjobat) duhet të jenë më të ulta, 61% e të anketuarve janë përgjigjur po, 15% e të anketuarve janë përgjigjur jo, 24% e të anketuarve janë përgjigjur vetëm disa nga ato.

Grafikoni 8 - A mendoni se ka nevojë për ndryshime ligjore sa i përket normimit të veprave kundërvajtëse?



Në pyetjen e nëntë, a mendoni se ka nevojë për ndryshime ligjore sa i përket normimit të veprave kundërvajtëse, 62% e të anketuarve janë përgjigjur po, 18% e të anketuarve janë përgjigjur jo, ndërsa 20% e të anketuarve janë përgjigjur shumë pak.

Grafikoni 9 - A keni patur rastin të shqiptoni gjoba kundërvajtëse nga lëmija e mbrojtjes së konkurrencës?



Në pyetjen e dhjetë, a keni pasur rastin të shqiptoni gjoba kundërvajtëse nga lëmija e mbrojtjes së konkurrencës, 38% e të anketuarve janë përgjigjur po disa herë, 11% e të anketuarve janë përgjigjur vetëm njëher, dhe 51 % e të anketuarve janë përgjigjur se anjëher.

• **Sipas mendimit tuaj, cilat janë përparsit e shqiptimit të gjobës si sanksion kundërvajtës dhe shqiptimit të dënimit në të holla (gjobës) si sanksion penal?**

Në lidhje me pyetjen e përparsive të gjobës si sanksion kundërvajtës dhe gjobës si sanksion penal, nga më të shpeshtat janë paraqitur këto përgjigje:

1.Përparsit e gjobës si sanksion kundërvajtës:

- a. Sanksionet kundërvajtëse janë më të lehta se ato penale;
- b. Sanksionet kundërvajtëse nuk paraqiten në evidencën kriminale (pra nuk janë të shkruajtura në librin e dënimeve);
- c. Sanksionet kundërvajtëse janë më të favorshme për personat e dënuar;
- d. Në sanksionet kundërvajtëse personi do jet më i kujdesshëm në përsëritjen e kundërvajtjes, nga fakti se me dënimin kundërvajtës i është privuar pasuria e tij;
- e. Sanksionet kundërvajtëse i përkasin procedurave më të shkurta, pra shumë më shpejt vijmë deri te shqiptimi i sanksionit gjobë kundërvajtëse;
- f. Te sanksionet kundërvajtëse gjithashtu dënimi është më i ulët;
- g. Në kundërvajtje përparsi tjetër është edhe evitimi i procedurës gjyqësore;

2. Përparsit e gjobës si sanksion penal:

- a. Kryersi i veprës penale dënimin me gjobë e shiqon si shpëtim për të, ose ndryshe thënë si lirim nga akuza;
- b. Poashtu me gjobën si sanksion penal arihet rehabilitimi gjyqësor;
- c. Gjopa në lëmin penal shifet edhe si zëvendësim i dënimit apo vuajtjes së dënimit me burg;
- d. Gjopa si sanksion penal është më e ulët, mirpo me procedurë më të gjatë, që dmth më lehtë për të akuzuarin nëse akuzohet për veprë penale dhe ti shqiptohet dënim në të holla (gjopa ditore), sesa për kundërvajtje, ku gjobat e kalojnë peshën e veprës së inkriminuar;
- e. Gjopa si sanksion penal ka vlerë më të ulët të dënimit në të holla;

3. Mendim i përbashkër për të dyja:

- a. Një grup i të anketuarve nuk pajtohet se ka përparsi në asnjërën prej sanksioneve;
- b. Sipas shumicës së përgjigjeve të mara konkludojmë se si përparsi më e madhe edhe e sanksioneve kundërvajtëse edhe e atyre penale është ndikimi preventiv ndaj qytetarëve, si dhe edukimi ndaj të dënuarve që mos të paraqiten si recidivist.


Pyetjet e grupit profesional dallonin nga ato të grupit të dytë, pasi që në këto pyetje termet e përdorura janë më profesionale dhe karakteri i pyetjeve më së shumti lidhet me ligjet dhe procedurat konkrete. Konkluzionet e nxjeruna nga ky grup na bënë të kuptojmë se: Vet profesionistët e çështjeve juridike të cilët edhe e ushtrojnë këtë profesion për disa sanksione, mënyrat e zbatimit dhe disa lloje dënimesh janë në kundërshtim me standardet sociale ekonomike të qytetarëve.

Si shembull konkret e kemi pyetjen numër 1: *A mendoni se gjobat e parapara sipas litgjit për kundërvajtje dhe ligjeve tjera materiale, janë në përputhje me standardet ekonomike të RM-së?* Ku rezultati është dukshëm i lartë (58 %) me përgjigjen e dhënë se : aspak nuk është në përputhje me standardin ekonomik.

Poashtu vlen të theksohet se përqindje e lartë (54 %) e palëve nuk kanë njohuri të mjaftueshme sa i përket çështjes së gjobave dhe zbatimit të tyre. Gjatë bisedës dhe diskutimeve që kemi pasur tek hulumtimi, shumica e juristëve janë shprehur se poashtu ka nevojë për ndryshime ligjore sa i përket normimit të gjobave kundërvajtëse, gjë që ishte e përfshirë në pyetsorë, ku 62 % e të anketuarve profesionist u shprehën pro ndryshimeve ligjore.


4.2. Të dhënat nga anketa e realizuar me qytetarë të cilët nuk kanë njohuri profesionale në lidhje me këtë tematik (Grupi laik):

Grafikoni 10 - A keni marur pjesë ndonjëherë në procedurë kundërvajtëse ose penale?




Në pyetjen e parë, a keni marur pjesë ndonjëherë në procedurë kundërvajtëse ose penale, 54% e të anketuarve janë përgjigjur po, ndërsa 46% e të anketuarve janë përgjigjur jo.

Grafikoni 11 - A keni qenë ndonjëherë i dënuar me dënim me gjobë?




Në pyetjen e dytë, a keni qenë ndonjëherë i dënuar me dënim me gjobë, 57% e të anketuarve janë përgjigjur po, ndërsa 43% e të anketuarve janë përgjigjur jo.

Grafikoni 12 - A keni njohuri se ekzistojn gjoba kundërvjtëse me shumë mbi 5000 Euro?




Në pyetjen e tretë, a keni njohuri se ekzistojn gjoba kundërvjtëse me shumë mbi 5000 Euro, 56% e të anketuarve janë përgjigju po, ndërsa 44% e të anketuarve janë përgjigjur jo.

Grafikoni 13 - A janë të larta gjobat kundërvajtëse, sipas standardit ekonomik në RMV?




Në pyetjen e katërt, a janë të larta gjobat kundërvajtëse, sipas standardit ekonomik në RMV, 91% e të anketuarve janë përgjigjur po, ndërsa 9% e të anketuarve janë përgjigjur jo.

Grafikoni 14 - A dini se përveçse ligjit për kundërvajtje sanksionet kundërvajtëse janë të parapara edhe në ligjet tjera?




Në pyetjen e pestë, a dini se përveçse ligjit për kundërvajtje sanksionet kundërvajtëse janë të parapara edhe në ligjet tjera, 45% e të anketuarve janë përgjigjur po, ndërsa 55% e të anketuarve janë përgjigjur jo.

Grafikoni 15 - A keni ndëgjuar se dikujt apo juve i ëshë shqiptuar krahas gjobës kundërvajtëse edhe sanksion tjetër kundërvajtës (masa siguruse)?




Në pyetjen e gjashtë, a keni ndëgjuar se dikujt apo juve i ëshë shqiptuar krahas gjobës kundërvajtëse edhe sanksion tjetër kundërvajtës (masa siguruse), 56% e të anketuarve janë përgjigjur po, ndërsa 44% e të anketuarve janë përgjigjur jo.

Grafikoni 16 - A ndodh shpesh që në shoqërinë tuaj të diskutoni rreth gjobave dhe problemeve gjyqësore?



Në pyetjen e shtatë, a ndodh shpesh që në shoqërinë tuaj të diskutoni rreth gjobave dhe problemeve gjyqësore, 93% e të anketuarve janë përgjigjur po, ndërsa 7% e të anketuarve janë përgjigjur jo.

Grafikoni 17 - Si mendoni a ka më shumë dënime me gjobë (si sanksion kundërvajtës) apo dënime në të holla (si sanksion penal) në RMV-së?



Në pyetjen e tetë, si mendoni a ka më shumë dënime me gjobë (si sanksion kundërvajtës) apo dënime në të holla (si sanksion penal) në RMV-së, 55% e të anketuarve janë përgjigjur dënime me gjobë, ndërsa 45% e të anketuarve janë përgjigjur dënime në të holla.

Si kategori më e prekur dhe që së drejtëpërsëdrejti vuajn qoftë dënime e parapara dhe njëkohësisht edhe pasojat e tyre janë qytetarët si palë e akuzuar në procedurat e lartpërmendura. Së pari brenga e tyre shprehet më ankesat për gjokat në të holla, të cilat janë shumë të larta dhe si rezultat i kësaj mos përputhje ekonomike me standardin e të ardhurave shpesh marrin vendime që të njëjtat mos ti paguajn duke shkaktuar pasojat të dyfishta.

Gjat anketimit rezultoi se shumica e të anketuarve 54% kanë qenë pjesë e procedurave qofshin ato penale apo kundërvajtëse ndërsa 57% e tyre kanë qenë të dënuar me dënime me gjokë.

Poashtu si element me përqindje të lartë na paraqitet edhe përgjigja lidhur me pyetjen se a ndodh shpesh që në shoqërinë tuaj të diskutoni rreth gjokave dhe problemeve gjyqësore? Përgjigja ishte po me 93% e të anketuarve në shoqërinë dhe rrethin e tyre se diskutojnë rreth problemit të dënimeve, ndërsa kjo përgjigje në shikim të parë bie në kontraditë me përgjigjen e dhënë në pyetësin profesional që profesionistët thonë se qytetarët posedojnë njohuri të pakta rreth dënimeve, ndërsa në përgjigjet e mësipërme me të njëjtit arimë të kuptojm se si target bisedimesh mes njerëzve janë gjokat dhe lartësia e tyre, ndërsa të paktë janë ata që flasin rreth procedurave se si zhvillohen këto procese.

4.3. Vendimet gjyqësore kundërvajtëse

Vendimi 1.

***Numri i lëndës:** « УП.6p.«19/2016»

***Gjykata:** Gjykata Administrative – Shkup;

***Këshilli Gjyqësor:** Nada Ivanova - Kryesuese e Këshillit; Gazmend Fejzuli Vesna Jovanovska - Anëtarë të Këshillit; Procesverbalist Nezat Rexhepi - bashkëpunor profesional.

***Palët:**

- Paditësit: Bashkim Bajrami nga Gostivari;

- I Paditur: Ministria për Punë të Brendshme, Departamentit për kundërvajtje, Njesisë për kundërvajtje në Gostivar;

***Lënda:** Anulimi i vendimit UP nr. 18.18-1871 të datës 09.12.2015

***Në seancë me datë 01.04.2016 solli këtë:**

AKTGJYKIM

- Padia e paraqitur nga paditësi Bashkim Bajrami nga Gostivari, **PRANOHET**.
- Vendimi i kontestuar i Republikës së Maqedonisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Seksioni për kundërvajtje, Komisioni për kundërvajtje në Departamentin e Kundërvajtjeve në Gostivar nr. 18.18-1871, datë 09.12.2015, **ANULOHET**.

***Kërkesa e palëve:**

— Deri te kjo gjykatë, Paditësi Bashkim Bajrami nga Gostivari ngriti padi për anulimin e vendimit të Republikës së Maqedonisë, Ministrisë për Punë të Brendshme, Departamentit për kundërvajtje, Njesisë për kundërvajtje në Gostivar UP nr. 18.18-1871 të datës 09.12.2015, për shkak se gjendja faktike të vërtetuar pjesërisht dhe të pasaktë, zbatimit të gabuar të ligjit material dhe shkeljes së procedurës.

— Organi i paditur në përgjigje në padi ka qëndruar në vendimin e tij për arsyet e theksuara në arsyetimin e të njejtit.

***Aktvendimi Paraprak:**

